

Majlinda Hala

Libër për mësuesin/en

Art muzikor 9



Libër për mësuesin/en

Art muzikor 9



Librin për mësuesin mund ta shkarkoni në linkun: <https://www.botimepegi.al/>

ISBN: 978-9951-843-36-2



9

BOTIME

pegi

Dr. Majlinda Hala

LIBËR PËR MËSUESIN/EN

ART MUZIKOR 9

Për klasën e 9-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2024



BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t:
????????????
Korrektor letrar: Ergys PETIRTI
Paraqitja grafike: Aida ÇELA
Kopertina: Florinda ZONJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-843-36-2

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, maj 2024
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht
të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim,
përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht
ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

*Të gjitha tekstet letrare dhe jolettrare të këtij libri janë përshtatur dhe redaktuar
për qëllime didaktike.*

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

PËRMBAJTJE

HYRJE	5
PLANI VJETOR	12
GJYSMËVJETORI I.....	15
GJYSMËVJETORI II	19
REFERENCA	109

I. HYRJE

Muzika kontribuon në zhvillimin fizik, emocional, intelektual, social dhe estetik të rinjve, pra në formimin e gjithanshëm, e posaçërisht në formimin kulturor të tyre duke e pasuruar botën e tyre shpirtërore, identitetin dhe personalitetin. Me gjuhën universale të cilën e kuptojnë të gjithë njerëzit pa dallim race, gjinie, e moshe, muzika i ndihmon nxënësit të kuptojnë dukuritë dhe proceset muzikore, për t'i shfrytëzuar ata për komunikim dhe shprehje artistike në kontekste të ndryshme. Si aktivitete shoqërore, që në zanafillën e paraqitjes së saj, muzika është mediumi që mundëson aktivitete të përbashkëta në grup, ku kërkohet bashkëpunimi në realizimin e këngëve, pjesëve muzikore me instrumente etj., duke u mundësuar nxënësve që të zhvillojnë shkathtësitë e ndryshme muzikore, krahas zhvillimit të kompetencave të tjera të përgjithshme.

Lënda Art muzikor në klasën e nëntë synon të:

- zhvillojë prirjet dhe zhvillojë shkathtësitë muzikore të nxënësve sipas interesimit dhe dispozitave individuale - veshin muzikor, këndimin, luajtjen në instrumente etj.;
- pasurojë “fjalorin” e termave dhe të koncepteve bazike të gjuhës muzikore, për të mundësuar komunikimin artistik;
- zhvillojë më thellë njohuritë e nxënësve për ritmin, melodinë, harmoninë, format muzikore, instrumentet, institucionet, krijuesit dhe performuesit;
- aftësojë nxënësit që të kultivojnë dëgjimin aktiv muzikor dhe të çmojnë e vlerësojnë krijimtarinë muzikore (kombëtare dhe botërore) të stileve dhe zhanreve të ndryshme muzikore;
- nxit nxënësit që të zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese muzikore;
- promovojnë krijuesit dhe performuesit, institucionet dhe ngjarjet e rëndësishme muzikore.

II. STILET E TË NXËNIT, PJESË E PLANIFIKIMIT TË MËSIMDHËNIES DHE ZHVILLIMIT TË ARTIT MUZIKOR, KLASA IX.

Planifikimi i punës mësimore dhe procesi i mësimdhënies është një fazë, e cila kërkon të japë njohuritë e duhura nxënësit, të nxitë nevojat e tyre, interesat dhe mënyrat e tyre të të mësuarit. Procesi mësimor do të ketë rezultate të suksesshme, nëse nxënësit janë të nxitur për të nxënë dhe ku secili nxënës mëson sipas një mënyre individuale apo të njohur në literaturën pedagogjike si stile të të nxënit. Disa nxënës mësojnë përmes perceptimit, të tjerë mësojnë duke analizuar apo reflektuar, disa përmes të parit dhe të dëgjuarit, disa mësojnë vetëm, të tjerë mësojnë në grupe, disa mësojnë në tërësi përmbajtjen mësimore, ndërsa të tjerë e ndajnë atë në pjesë më të vogla logjike.

Krahas këtyre përcaktimeve të të nxënit, janë mësimdhënësit, të cilët gjatë përdorimit të strategjive dhe metodave të mësimdhënies në procesin mësimor, nxjerrin në pah artin dhe mjeshtërinë e tyre, por edhe vënë në zbatim përmes stileve të të nxënit këto metoda. Mësimdhënësit në mësimin e muzikës duhet të përdorin më shumë demonstrimin, bisedën, lojën me role, kllasterin, brainstorming, hartën e koncepteve, pyetje për pyetje, diskutimet. Për të pasur sukses në procesin mësimor, duhet patjetër që mësimdhënësi të zbatojë stilet e të nxënit, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënit dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura. Stilet e të nxënit, nëpërmjet metodave dhe teknikave të mësimdhënies përmbush detyra të rëndësishme të mësimdhënies. Kështu:

II.1. Stili i të nxënit pamor, është kur nxënësi e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së të parit. Në këtë rast mësimi konkretizohet, duke përdorur mjete mësimore, si: fotografi, grafikë, piktura, ngjyra, ilustrime, instrumente muzikore, DVD (ku ndërthuret edhe stili i dëgjimit). Të nxënit përmes të parit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi ku kërkohet përqendrimi i nxënësve në:

- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të memorizuar apo për të kujtuar një ndodhi, një ngjarje, një situatë të caktuar në kontekstin e temës mësimore.

- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të nxitur diskutimin apo për të verifikuar njohuritë e marra më parë.

II.2. Stili i të nxënësve dëgjimor është kur nxënësi e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së dëgjimit. Këta nxënës përvetësojnë më mirë dhe më lehtë njohuritë nëpërmjet dëgjimeve të fragmenteve muzikore, improvizime përmes lëvizjeve trupore, krijimeve nëpërmjet përjetimit nga dëgjimi i muzikës ku bëhen krijime të ndryshme dhe diskutohet për to. Të nxënësve përmes dëgjimit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi ku kërkohet përfshirja e nxënësve në:

- dëgjimin e muzikës dhe edukimin e përqendrimit për të dëgjuar muzikë;
- dëgjimin e muzikës dhe mësimin e këngëve për fëmijë apo këngëve lojë dhe diskutimin në lidhje me tekstin dhe melodinë e këngës;
- dëgjimin e muzikës dhe improvizimin përmes lëvizjeve trupore apo vizatimit në kontekstin e temës mësimore;
- dëgjimin e muzikës dhe nxitjen e bisedave apo diskutime në lidhje me fragmentin muzikor që dëgjon;
- dëgjimin e muzikës dhe prezantimin e krijimeve të ndryshme të krijuara nën përjetimin e muzikës.

II.3. Stili i të nxënësve kinestetik, është kur nxënësi përvetëson përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, duke vepruar, luajtur, shkruar, vizatuar etj. Këta nxënës janë më të suksesshëm nëse:

- ☺ e prekin dhe e ndiejnë përmbajtjen mësimore;
- ☺ përdorin pjesët trupore dhe ndjenjat;
- ☺ përdorin gjuhën e ndjenjave.

Përmes stileve të të nxënësve kinestetik zhvillojnë prirje dhe shkathtësi të ndryshme p.sh.: bashkëveprimi në lojëra të ndryshme muzikore, apo aktivitete në grup, performime muzikore dhe kërcime në shfaqjet skenike, kërcim apo teatër, biseda në lidhje me temën e mësimin etj.

Të tria këto stile harmonizohen dhe ndihmojnë çdo mësimdhënës të planifikojë veprimtari të larmishme mësimore muzikore, duke i përdorur ato përmes teknikave dhe metodave të mësimdhënies.

Disa veprimtari muzikore që kanë të bëjnë me procesin e mësimin të muzikës ku ndihmojnë dhe stilet e të nxënësve janë:

- 1) Mësimi i këngëve bën pjesë në stilin e të nxënësve pamor, dëgjimor por edhe kinestetik, sepse këngët duhet:
 - të mësohen;
 - të këndohen duke respektuar të gjitha kërkesat e këndimit dhe repertori i sugjeruar për t'u mësuar;
 - të shoqërohet edhe me instrumente muzikore/popullore;
 - të shoqërohet me lëvizje trupore.
- 2) Në fushën e lojës me instrumente muzikore mësuesi bashkëpunon dhe synon vënien në përdorim të funksionit të muskujve të duarve gjatë luajtjes në instrument muzikor duke i angazhuar nxënësit në përdorimin e instrumenteve muzikore popullore shqiptare të ngjashme edhe me instrumentet ORF për shoqërimin e këngëve që këndojnë.
- 3) Dëgjimi muzikorbën pjesë në stilin e të nxënësve dëgjimor, por edhe pamor, sepse edukon përqendrimit dhe vëmendjen ndaj dëgjimit të muzikës, dhe memorizimin e njohurive muzikore në përjetimin e muzikës përmes veprave muzikore shqiptare dhe ato botërore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies për të përmbushur stilet e të nxënësve në muzikë janë të shumta, dhe i japin mundësinë çdo nxënësi të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor dhe artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimin të muzikës do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë, kuptojnë, krijojnë dhe performojnë muzikën nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike.


Metodat dhe teknikat e mësimdhënies për të përmbushur stilet e të nxënësve në muzikë janë të shumta, dhe i japin mundësinë çdo nxënësi të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor dhe artistik, që zotëron

brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimin të muzikës do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë, kuptojnë, krijojnë dhe performojnë muzikën nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike.

Disa teknika shumë efikase në orën e muzikës janë Brainstorming, Kllaster, Harta e të pyeturit, Diagrama e Venit, DDM, Harta e koncepteve, Kubimi, INSERT etj.

III. TEKNIKA TË MËSIMDHËNIES

Në stilin e të nxënës përfshihet pamor dhe dëgjimor veçojmë edhe teknikën e kllasterit. Kllasteri, ose grupimi i mendimeve që, ndonjëherë, në literaturë emërtohet “harta e mendimeve”, është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të mësimin, duke sjellë nga kujtesa njohuritë muzikore që ata kanë dhe plotësuar ata më tej gjatë fazave të tjera të orës mësimore.



Rrjeti i diskutimit është një teknikë e mësimdhënies, gjatë së cilës bëhet organizimi grafik i informacionit. Kjo teknikë i bën nxënësit të jenë të vëmendshëm ndaj dëgjimit të veprave muzikore, për të kuptuar përmbajtjen muzikore të veprave dhe krahasuar ato. Përdoret në fazën e realizimit të kuptimit dhe të reflektimit. Sipas kësaj teknike, klasa ndahet në dy grupe (“Pro” dhe “Kundër”). Grupet mund të jenë edhe mbi 20 veta. Diskutimi midis grupeve vazhdon 15-25’, sipas temës dhe mund të realizohet me nxënës të çdo moshe.



Brainstorming, është një veprimtari që bën pjesë në stilin pamor por edhe dëgjimor, duke iu përshtatur lëndës së muzikës sepse nëpërmjet vendosjes së një fjale kryesore apo fragmenti muzikor për dëgjim CD, shërben si fillimi i një diskutimi në mësim për një problem të caktuar, i cili më pas vazhdon me metoda e teknika të tjera.

Qëllimi i përdorimit të Brainstorming-ut është të vërë në dukje sa më shumë ide, zgjidhje ose komente për një problem të dhënë. Brainstorming-u përdoret për të shprehur ide të reja me të gjithë klasën ose me një grup nxënësish dhe karakterizohet nga një lojë me përmasa të gjera dhe nga një intensitet i të shprehurit të larmishëm për gjëra të njohura. P.sh. *shkruhet në dërrasë të zezë, fjala "Muzika profesioniste shqiptare", ose vendosjen e një muzike mjaft të njohur për dëgjim ku nxënësve u kërkohet të flasin rreth asaj që dinë mbi veprën muzikore, llojin e saj apo kompozitorin e veprës muzikore, duke sjellë informacion rreth kohës që ailajo jetoi.*

Kjo teknikë kërkon që çdo mësime dhënë të mbajë parasysh:

- Asnjë prej zgjidhjeve e ideve të mos kritikohet.
- Të nxiten nxënësit të shprehin ide.
- Diskutimi të zhvillohet për gjëra të njohura.
- Të aktivizohen edhe nxënës të ndrojtur.
- Të shërbejë si nxehje e trurit.

Kubimi është një teknikë që mund të bëjë pjesë në **stilin dëgjimor**, sepse përmes vendosjes së një veprë dëgjimore shqiptare, ndihmon shqyrtimin e veprës nga këndvështrime të ndryshme, për shkak të përjetimit emocional që është i ndryshëm te gjithsecili. Ai përfshin përdorimin e një kubi me lëvizje të shpejta për të menduarin, të shkruarin në secilën faqe të kubit. Mund të ndërtohet duke mbuluar një kuti të vogël me letër. Në secilën faqe të kubit shkruhen 6 kërkesa të shkurtra: Përkrahja, krahasoje, shoqëroje, analizoje, argumentoje (pro ose kundër) p.sh.:

- vepër muzikore, këngën, muzikën popullore, dy kompozitorë, ku nxënësit udhëzohen të mendojnë për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të mësuesit dhe ta përshkruajnë atë: (forma muzikore, karakteri i veprës, subjekti që trajton vepra etj.).

Tabela e koncepteve, është një teknikë që bën pjesën e stilit dëgjimor, një teknikë racionale për të organizuar informacionin muzikor përmes dëgjimit dhe krahasimit të disa veprave muzikore. Përdoret veçanërisht kur jepen njëkohësisht më shumë se një koncept a dukuri. Ndihmon së tepërmi të kuptuarit, përmes strukturimit të materialit, pas leximit dhe në realizimin e skemave të qarta, që sigurojnë qëndrueshmërinë e dijeve. Kjo teknikë përdoret me sukses në fazën e realizimit të kuptimit dhe reflektimit. Tabela e koncepteve hartohet duke renditur konceptet apo njohuritë muzikore, që duhet të krahasohen dhe në kolona renditen tiparet apo karakteristikat mbi bazën e të cilave bëhet ky krahasimi i veprave muzikore.






Diagrama e Venit është teknikë që bën pjesë në **stilin dëgjimor** më anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve muzikore, formave muzikore, ngjarjeve muzikore, kompozitorëve të ndryshëm, 2 periudhave muzikore etj. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit, pothuajse në çdo orë mësimi. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimit, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.



Harta e të pyeturit është teknikë që i përket **stilit pamor dhe dëgjimor**:

është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të mësimit, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit e cila shoqërohet me fragmente të ndryshme muzikore. Përparësitë:

- Hap rrugën për diskutim.
- Ndhmon nxënësit për të zhvilluar aftësi më të mëdha të të menduarit.
- Tërheq nxënësit në punët e pavarura.
- Rrit rolin e nxënësve në mësim.
- Nxit të menduarit logjik.
- Nxit dhe tërheq nxënësit pasivë.



Si të krijojmë një hartë të pyeturi? Për të përpiluar një hartë të pyeturi, mund të ndiqet kjo rregullsi:

- Shkruhet tema e mësimit që do të shpjegohet në qendër të tabelës.
- Pas kësaj vizatohet harta e të pyeturit, në të cilën pas pyetjeve kyçe, gjenden të lidhura edhe pyetje të tjera që zgjerojnë hartën.

Të mësuarit me projekte (Projekti)

- Projekti kurrikular është strategji e të nxënit dhe mësimdhënies, me në qendër nxënësin, përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj.
- Projekti kurrikular në lëndën e muzikës është **rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënit**.
- Projekti kurrikular **nuk** duhet të përmbajë njohuri të reja.
- Zbatimi i një projekti në lëndën e muzikës kërkon më shumë se një orë mësimore.
- Projekti kurrikular **mund** të jetë i shtrirë **përgjatë gjithë vitit shkollor**, pra në të tri periudhat, por mund të jetë i shtrirë dhe **vetëm brenda një periudhe**. Sido që të jetë shtrirja e projektit, ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Mësuesi, që kur planifikon projektin, duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit përgjatë zhvillimit të tij.

IV. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Gjatë mësimit të muzikës për realizimin e kompetencave, mësmdhënësi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi/ja i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedisin e përshtatshëm për aktivitete. Teknologjia ka një ndikim të madh në muzikë duke ndihmuar nxënësit/et të eksplorojnë këngë me tematikë të ndryshme, për të rinj, arie, muzikal, vepra muzikore të ndryshme, duke zhvilluar aftësitë e tyre në njohjen më të plotë të muzikës.

Tekstet dhe materialet sigurojnë përmes përdorimit të tyre një qasje të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Me anë të mediave, detyrave dhe projekteve të ndryshme nxënësve/eve u krijohet mundësia të demonstrojnë apo të prezantojnë punët dhe krijimet e tyre.

Muzika studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike muzikore, p.sh: për dëgjim muzikor, shikim të shfaqjeve për ndjekjen e pjesëve muzikore, të këngëve përdoren magnetofoni, TV-ja, CD dhe DVD.

Përveç materialeve, shfrytëzohen edhe burime mësimore, si: teksti shkollor, internet etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Mjetet audiovizive, si: TV, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.*
- *Mjetet dëgjimore: radio, magnetofon etj.*
- *Mjetet verbale, tekstet si: tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve/eve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për muzikën. Ky plan është i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në krijime të ndryshme.*
- *Mjedisi mësimor (klasa, kabinetet e muzikës etj.).*

V. ORGANIZIMI DHE KUPTIMI I TEKSTIT TË NXËNËSIT, SIPAS PROGRAMIT MËSISMOR

Ky tekst mësimor është organizuar në katër koncepte dhe tema mësimore. Ato janë:

1. Krijimtaria dhe performanca artistike

- Këngë
- Bllokflaut
- Krijim muzikor

2. Gjuha dhe komunikimi artistik

- Elementet muzikore
- Shkrimi dhe leximi muzikor
- Shkallët muzikore

3. Muzika dhe shoqëria

- Zhanret muzikore
- Gjinitë muzikore
- Instrumentet dhe formacionet muzikore
- Krijues dhe interpretues

4. Çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik

- Ngjarje muzikore
- Vepra muzikore

Në çdo njësi mësimore merren informacione të reja për këngët, veprat dhe kompozitorët nëpërmjet zhvillimit të veprimtarive muzikore: këndim, dëgjim, interpretim dhe vlerësim. Në fund, zotërohen njohuri dhe aftësi të mjaftueshme muzikore e kulturore, të cilat provohen në një testim, koncert apo paraqitje të një teme të caktuar, duke punuar vetëm ose në grup.

12 PLANI VJETOR

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA: ART MUZIKOR

KLASA: IX

NJËSITË MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkollës
GJYSMËVJETORI I		GJYSMËVJETORI II		
Shtator-tetor (9 orë)	Nëntor-dhjetor (8 orë)	Janar-shkurt-mars (11 orë)	Prill-maj-qershor (9 orë)	I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv I.3. I.6. I.7 I.8. I.9.
Rikujtojmë (1 orë)				
Këngë (2 orë)	Këngë (2 orë)	Këngë (3 orë)	Këngë (2 orë)	
Interpretim në instrumente (1 orë)	Interpretim në instrumente (1 orë)	Interpretim në instrumente (1 orë)	Interpretim në instrumente (1 orë)	
Kreativitet muzikor (1 orë)	Kreativitet muzikor (1 orë)		Kreativitet muzikor (1 orë)	
Shkrimi-leximi muzikor (1 orë)				
Zhanret muzikore (2 orë)	Zhanret muzikore (2 orë)	Zhanret muzikore (3 orë)	Mjete teknike për dëgjim dhe incizim (1 orë)	
Krijues dhe performues (1 orë)	Krijues dhe performues (2 orë)	Krijues dhe performues (3 orë)	Krijues dhe performues (1 orë)	
			Instrumente muzikore (1 orë)	
			Profesione (1 orë)	II. Kompetenca e të menduarit-Mendimtar kreativ II.1. II.3. II.5.
		Planifikim për mësimdhënësin (1 orë)	Planifikim për mësimdhënësin (1 orë)	

II.7.				
III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm				
III.4.				
III.5.				
IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv				
IV.1.				
IV.3.				
IV.6.				
V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë				
V.2.				
V.4.				
VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm				
VI.1.				
VI.2.				
VI.3.				
VI.5.				

Rikujtojmë

- 1.1 Këngë arbëreshe
- 1.2. Tonaliteti në muzikë
- 1.3. Ushtrime këndimi
- 1.4. Luajmë në instrument
- 1.5. Niket Dardani dhe Jan Kukuzeli
- 1.6. Muzika dhe shoqëria në Mesjetë
- 1.7. Krijim muzikor
- 1.8. Jeta kërkon dashuri
- 1.9. Kultura muzikore gjatë Rilindjes

- 1.10. Për ty Atdhe
- 1.11. Kultura muzikore gjatë Barokut
- 1.12. Përfaqësues dhe vepra muzikore
- 1.13. Kur bie fyelli e çiftelia
- 1.14. Luajmë në instrument
- 1.15. Kultura muzikore gjatë Klasicizmit
- 1.16. Përfaqësues dhe vepra muzikore
- 1.17. Intervista muzikore
- 1.18. Interpretues kosovarë

- 1.19. Kultura muzikore gjatë Romantizmit
- 1.20. Përfaqësues dhe vepra muzikore
- 1.21. La donna e mobile
- 1.22. Krijues dhe interpretues shqiptarë
- 1.23. Muzika në shekullin XIX/XX
- 1.24. Përfaqësues dhe vepra
- 1.25. Luajmë në instrument
- 1.26. Njerëzit e agimeve
- 1.27. Muzika moderne, rryma dhe përfaqësues
- 1.28. The final countdown

- 1.29. Këngë moj
- 1.30. Krijim muzikor
- 1.31. Mall për mëmëdhenë
- 1.32. Interpretues shqiptarë
- 1.33. Mjete teknike për dëgjim dhe incizim
- 1.34. Luajmë në kitarë
- 1.35. Luajmë në instrument
- 1.36. Profesionet muzikore

GJYSMËVJETORI I

MUAJT: SHTATOR-TETOR / NËNTOR-DHJETOR

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA MËSIMORE: ART MUZIKOR

KLASA: IX

KONCEPTI I: KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

TEMA MËSIMORE: KËNGËT, INTERPRETIME NË INSTRUMENTE DHE KREATIVITET MUZIKOR

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

IV.6. Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

V.4. Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët.

VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.

VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

RNF.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

RNF.4.

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

1.1. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.

1.2. Përjeton, analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike elementet karakteristike dalluese të kryeveprave artistike të trashëgimisë kulturore dhe artistike (muzikore, pamore, dramë, vallëzim) në kontekst kombëtar dhe më të gjerë.

1.3. Çmon diversitetin kulturor në rajon dhe më gjerë.

KONCEPTI II: GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK

TEMA MËSIMORE: ELEMENTET MUZIKORE, SHKRIMI MUZIKOR

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyesë në mënyrë konstruktive.

I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.

I.9. Iniciimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

IV.6. Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

V.4. Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët.

VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.

VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

RNF.2.

Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore

të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

- 1.1. Përdorin në mënyrë efektive njohuritë e tyre mbi elementet, proceset dhe teknikat interpretuese dhe krijuese artistike duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake.
- 1.2. Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri para audiencave të ndryshme, duke kombinuar format dhe mjetet shprehëse të arteve edhe me ndihmën e teknologjisë (prezantime multimediale, instalacione etj.).
- 1.3. Dallojnë aplikimet e inovacioneve në teknika shprehëse dhe medime bashkëkohore të artit (si video arti, instalacioni, performanca etj.), në veprat e artit bashkëkohor.
- 1.4. Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).
- 1.5. Analizojnë dhe krahasojnë traditat e ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.

KONCEPTI III: MUZIKA DHE SHOQËRIA

TEMA MËSIMORE: ZHANRE MUZIKORE, KRIJUES DHE PERFORMUES

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

- I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
- I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyesë në mënyrë konstruktive.
- I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
- I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

- II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtarë muzikore.
- II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
- II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

- III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
- III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

- IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
- IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.
- IV.6. Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

- V.2 Dëshmim i vetëbesimit
- V.4. Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët.

VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.

VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënësve të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

RNF.3.

Nxënësist kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor.

1.1. Njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror.

1.2. Demonstron të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile).

1.3. Prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.

RNF.4.

Nxënësist aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

1.1. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.

1.2. Përjeton, analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike elementet karakteristike dalluese të kryeveprave artistike të trashëgimisë kulturore dhe artistike (muzikore, pamore, dramë, vallëzim) në kontekst kombëtar dhe më të gjerë.

1.3. Çmon diversitetin kulturor në rajon dhe më gjerë.

MUAJTI: SHTATOR–TETOR (9 orë) / NËNTOR–DHJETOR (8 orë)

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Temat mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Këngët	- Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë) sipas tekstit notal dhe imitimit - Interpreton në performanca të ndryshme të kombinuara (muzikë, dramë, vallëzim).	1.1. Këngë arbëreshe 1.4. Jeta kërkon dashuri 1.10. Për ty Atdhe 1.13. Kur bie fyelli e çiftelia	4 orë	Bisedë Diskutim <i>Brainstorming</i> Diagrama e Venit Harta e të pyeturit Kllaster Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Fushat 1. Gjuhët dhe komunikimi 2. Artet 3. Matematika 4. Shkencat e natyrës 5. Shoqëria dhe mjedisi 6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti 7. Jeta dhe puna Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësimi - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, QR code DVD

				Harta e të pyeturit Kllaster Punë individuale	Vlerësim i ndërsjellë	Çëshjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësia - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, <i>QR code</i> DVD
Shkri Shkrimi muzikor	- Njeh parimin e tonaliteteve të ndryshme muzikore dhe simbolet e tyre. - Përdor në mënyrë efektive dhe të vetëdijshme e kreative, elementet e gjuhës muzikore (ritmet, meloditë) në këndim, luajtje në instrumente muzikore dhe krijim të tërësive të reja muzikore.	1.2. Tonaliteti në muzikë 1.3. Ushtrime këndimi	2 orë	Bisedë Diskutim <i>Brainstorming</i> Diagrama e Venit Harta e të pyeturit Kllaster Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Fushat 1. Gjuhët dhe komunikimi 2. Artet 3. Matematika 4. Shkencat e natyrës 5. Shoqëria dhe mjedisi 6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti 7. Jeta dhe puna Çëshjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësia	

Zhanre muzikore	- Dallon dhe krahason veprat sipas zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, xhaz, rok, muzikë festive etj.) përmes dëgjimit muzikor dhe këngëve që këndojnë.	1.7. Muzika dhe shoqëria në Mesjetë 1.9. Kultura muzikore gjatë Rilindjes 1.11. Kultura muzikore gjatë Barokut 1.15. Kultura muzikore në klasicizëm	4 orë	Bisedë Diskutim <i>Brainstorming</i> Diagrama e Venit Harta e të pyeturit Kllaster Punë individuale	Buletini i pjesëmarjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Fushat 1. Gjuhët dhe komunikimi 2. Artet 3. Matematika 4. Shkencat e natyrës 5. Shoqëria dhe mjedisi 6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti 7. Jeta dhe puna Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathhtëritë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësia	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, <i>QR code</i> DVD
Krijues dhe performues	- Njeh zhvillimet që kanë ndikuar në paraqitjen dhe përsosjen e gjinive të caktuara muzikore në periudha të ndryshme. - Njeh përfaqësuesit kryesorë të llojit/ gjinisë muzikore dhe kontributin konkret të tij/saj.	1.6. Niket Dardani dhe Jan Kukuzeli 1.12. Përfaqësues dhe vepra muzikore		Bisedë Diskutim <i>Brainstorming</i> Diagrama e Venit Harta e të pyeturit	Buletini i pjesëmarjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Fushat 1. Gjuhët dhe komunikimi 2. Artet 3. Matematika 4. Shkencat e natyrës 5. Shoqëria dhe mjedisi 6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti 7. Jeta dhe puna	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, <i>QR code</i> DVD

- Analizon dhe krahason rrethanat shoqërore historike që kanë ndikuar në zhvillimin e stileve të ndryshme muzikore - Njeh krijuesit dhe performuesit e veprave muzikore artistike që dëgjon, nga literatura botërore e periudhave dhe stileve të ndryshme dhe nga krijimtaria kombëtare. - Njeh, analizon dhe krahason veprat muzikore të dëguara, sipas karakteristikave themelore: formës, tonalitetit, stilit, periudhës, gjinisë/ llojit, formacionit interpretues dhe krijuesve të tyre.	1.16. Interpretues shqiptarë	3 orë	Kllaster Punë individuale	Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësimi - Edukimi për media		

GJYSMËVJETORI II

MUAJT: JANAR-MARS

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA MËSIMORE: ART MUZIKOR

KLASA: IX

KONCEPTI I: KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

TEMA MËSIMORE: KËNGËT DHE INTERPRETIME NË INSTRUMENTE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyesë në mënyrë konstruktive.

I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.

I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit

II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

IV.6. Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

V.4. Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët.

VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.

VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

RNF 1

I.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

RNF.4.

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

4.1. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.

KONCEPTI III: MUZIKA DHE SHOQËRIA

TEMA MËSIMORE: ZHANRE MUZIKORE DHE KRIJUES DHE PERFORMUES

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyesë në mënyrë konstruktive.

I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.

I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.

II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

IV.6. Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

V.4. Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët.

VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.

VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxëniet të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

RNF.3.

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor

- 1.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror;
- 1.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile).
- 1.3. prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.

RNF.4.

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

- 1.4. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.
- 1.5. Përjeton, analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike elementet karakteristike dalluese të kryeveprave artistike të trashëgimisë kulturore dhe artistike (muzikore, pamore, dramë, vallëzim) në kontekst kombëtar dhe më të gjerë.
- 1.6. Çmon diversitetin kulturor në rajon dhe më gjerë.

MUAJT: JANAR-MARS (11 orë)							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Temat mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Këngët	- Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë) sipas tekstit notal dhe imitimit	- Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë)	3 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Fushat 1. Gjuhët dhe komunikimi 2. Artet 3. Matematika 4. Shkencat e natyrës 5. Shoqëria dhe mjedisi 6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti 7. Jeta dhe puna	Teksti shkollor Softuerë arsimorë,
	- Interpreton në performanca të ndryshme të binuara (muzikë, dramë, vallëzim).	1.26. Njerëzit e agjimeve		Diagrama e Venit	Portofoli i nxënësit	Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	QR code DVD
		1.28. The final countdown		Harta e të pyeturit	Vlerësim i ndërsjellë	- Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	
				Klaster			
				Punë individuale			

Interpretim në instrumente	- Shfaqen këngët dhe luan pjesë instrumentale sipas imitimit ose me tekst notal, në zhanre të ndryshme, individualisht dhe në grupe	1.25. Luajmë në instrument	1 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Fushat	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, QR code DVD
				Diskutim	Portofoli i nxënësit	1. Gjuhët dhe komunikimi 2. Artet 3. Matematika 4. Shkencat e natyrës 5. Shoqëria dhe mjedisi 6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti 7. Jeta dhe puna Çështjet ndërkurrikulare	
				Brainstorming	Vlerësim i ndërsjellë	- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	
				Diagrama e Venit			
				Harta e të pyeturit			
				Kllaster			
				Punë individuale			

Zhanre muzikore	- Dallon dhe krahason veprat sipas zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, xhaz, rok, muzikë festive etj.) përmes dëgjimit muzikor dhe këngëve që këndojnë.	1.19. Kultura muzikore në Romantizëm	3 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Fushat	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, QR code DVD
		1.23. Muzika në shekullin XIX/XX		Brainstorming	Portofoli i nxënësit	1. Gjuhët dhe komunikimi 2. Artet 3. Matematika 4. Shkencat e natyrës 5. Shoqëria dhe mjedisi 6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti 7. Jeta dhe puna	
		1.27. Muzika moderne, rryma dhe përfaqësues		Diagrama e Vënit	Vlerësim i ndërsjellë	Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia	
				Harta e të pyeturit			
				Klaster			
				Punë individuale			

Krijues dhe performues	- Njih krijesit, performuesit e veprave muzikore artistike nga literatura botërore e periudhave të ndryshme.	1.20. Përfaqësues dhe vepra muzikore	3 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Fushat 1. Gjuhët dhe komunikimi 2. Artet 3. Matematika 4. Shkencat e natyrës 5. Shoqëria dhe mjedisi 6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti 7. Jeta dhe puna	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, QR code DVD
	- Njih vepra dhe krijues të shquar të muzikës artistike kombëtare.	1.22. Krijues dhe interpretues shqiptarë					
	- Vlerëson këndimin dhe interpretimin e vet dhe të tjerëve						
	- Vlerëson veprat muzikore, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.	1.24. Përfaqësues dhe vepra					
						Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	

GJYSMËVJETORI II (VAZHDIM)
MUAJT: PRILL-QERSHOR
FUSHA E KURRIKULËS: ARTE
LËNDA MËSIMORE: ART MUZIKOR
KLASA: IX

KONCEPTI I: KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE
TEMA MËSIMORE: KËNGËT DHE KREATIVITET MUZIKOR

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

- I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
- I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthye në mënyrë konstruktive.
- I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjes në komunikim.
- I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

- II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
- II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit
- II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

- III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
- III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

- IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

- V.2 Dëshmim i vetëbesimit

VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm:

- VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
- VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

RNF 1

- I.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

RNF.2.

Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

- 2.1. Përdorin në mënyrë efektive njohuritë e tyre mbi elementet, proceset dhe teknikat interpretuese dhe krijuese artistike duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake.
- 2.6. Analizojnë dhe krahasojnë traditat e ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.

RNF.4.

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

- 4.1. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.

KONCEPTI III: MUZIKA DHE SHOQËRIA

TEMA MËSIMORE: ZHANRE MUZIKORE, INSTRUMENTE DHE FORMACIONE MUZIKORE, KRIJUES DHE PERFORMUES

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

- I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
- I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyesë në mënyrë konstruktive.
- I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
- I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

- II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
- II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit
- II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm

- III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
- III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

- IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

- V.2 Dëshmim i vetëbesimit

VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm:

- VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
- VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

RNF. 3.

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor

- 1.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror;
- 1.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile).
- 1.3. prezantoi disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.

RNF.4.

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

- 1.1. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.
- 1.2. Përjeton, analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike elementet karakteristike dalluese të kryeveprave artistike të trashëgimisë kulturore dhe artistike (muzikore, pamore, dramë, vallëzim) në kontekst kombëtar dhe më të gjerë.
- 1.3. Çmon diversitetin kulturor në rajon dhe më gjerë.

KONCEPTI IV: ÇMUARJE DHE VLERËSIM ESTETIKO-ARTISTIK**TEMA MËSIMORE: PROFESIONE MUZIKORE DHE NGJARJE MUZIKORE**

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

RNF. 3.

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor

- 1.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror;
- 1.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile).
- 1.3. prezantoi disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.

RNF.4.

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

- 1.1. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.
- 1.2. Përjeton, analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike elementet karakteristike dalluese të kryeveprave artistike të trashëgimisë kulturore dhe artistike (muzikore, pamore, dramë, vallëzim) në kontekst kombëtar dhe më të gjerë.
- 1.3. Çmon diversitetin kulturor në rajon dhe më gjerë.

MUAJT: PRILL-QERSHOR (9 orë)							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxëniet për tema mësimore	Temat mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Këngët	- Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë) sipas tekstit notal dhe imitimit	1.29. Këngë moj	2 orë	Bisedë Diskutim Brainstorming	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit	Fushat 1. Gjuhët dhe komunikimi 2. Artet 3. Matematika 4. Shkencat e natyrës 5. Shoqëria dhe mjedisi 6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti 7. Jeta dhe puna	Teksti shkollor Softuerë arsimorë,
	- Interpreton në performanca të ndryshme të kombinuara (muzikë, dramë, vallëzim).	1.31. Mall për mëmëdhenë		Diagrama e Venit Harta e të pyeturit Kllaster Punë individuale	Vlerësim i ndërsjellë	Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësia - Edukimi për media	QR code DVD

Instru- mente dhe for- macione muzikore	- Analizon karakteristikat tingëllore dhe funksionale të instrumenteve të ndryshme muzikore. - Dallon dhe krahason ansam- blet e ndryshme muzikore sipas funksionit dhe llojit.	1.34. Njo- him kitarën	1 orë	Bisedë Diskutim Brainstorming Diagrama e Venit Harta e të pyeturit Kllaster Punë individ- uale	Buletini i pjesëmar- rjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Fushat 1. Gjuhët dhe komunikimi 2. Artet 3. Matematika 4. Shkencat e natyrës 5. Shoqëria dhe mjedisi 6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti 7. Jeta dhe puna Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrue- shëm - Zhvillimi personal dhe shkath- tësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, QR code DVD
---	--	------------------------	-------	--	--	---	---

		1 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Fushat	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, QR code
Krijues dhe performues	- Njeh krijuesit, performuesit e veprave muzikore artistike nga literatura botërore e periudhave të ndryshme.	1.32. Interpretues shqiptarë dhe kosovarë	Diskutim	Portofoli i nxënësit	1. Gjuhët dhe komunikimi	Softuerë arsimorë, QR code
	- Njeh vepra dhe krijues të shquar të muzikës artistike kombëtare.		Brainstorming		2. Artet	
	- Vlerëson këndimin dhe interpretimin e vet dhe të të tjerëve		Diagrama e Venit		3. Matematika	
	- Vlerëson veprat muzikore, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.		Harta e të pyeturit		4. Shkencat e natyrës	
			Kllaster	Vlerësim i ndërsjellë	5. Shoqëria dhe mjedisi	
			Punë individuale		6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	DVD
					7. Jeta dhe puna	
					Çështjet ndërkurrikulare	
					- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike	
					- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
					- Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë	
					- Globalizimi dhe ndërvlerësia	
					- Edukimi për media	

Çmuarje dhe vlerësim artistiko-estetik	- Shprehet për karakteristikat e veprës muzikore (formën, llojin, zhanrin përmbajtjen) me komentim, me shkrim, forma vizuale, prezantim me teknologji bashkëkohore.	1.33. Mjete teknike për dëgjim dhe incizim 1.36. Profesione muzikore	2 orë	Bisedë Diskutim Brainstorming Diagrama e Venit Harta e të pyeturit Kllaster Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Fushat 1. Gjuhët dhe komunikimi 2. Artet 3. Matematika 4. Shkencat e natyrës 5. Shoqëria dhe mjedisi 6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti 7. Jeta dhe puna Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësimi - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë, QR code DVD
--	---	---	-------	--	--	--	---

VII. PLANIFIKIME DITORE TË LËNDËS, ART MUZIKOR, KLASA 9-TË

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (Nëntë)
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik Tematika: Shkrimi dhe leximi muzikor		Rezultatit të nxënës të temës: Nxënësi/ja: - dallon, analizon dhe krahason elementet muzikore në veprat muzikore që dëgjon; - përdor në mënyrë efektive dhe të vetëdijshme e kreative, elementet e gjuhës muzikore (ritmet, meloditë) në këndim, luajtje në instrumente muzikore dhe krijim të tërësive të reja muzikore; - njuh dhe përdor funksionin dhe emërtimin e elementeve shprehëse muzikore, si p.sh.:nuanca të ndryshme në temp, dinamike, harmoni etj; - dallon, përpunon dhe prezanton karakteristikat, risitë dhe veçantitë e gjuhës dheshprehjes muzikore në periudhat e ndryshme stilistike.	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF. 1. Demonstron prirje për të zhvilluar ndonjë ose disa shkathtësi artistikenë muzikë, dramë, arte pamore e vallëzim. - Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal; Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. - Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë. - Krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Rikujtojmë			
Fjalët kyçe: melodi e këngës, tekst i këngës, shkallët muzikore,ritmet muzikore, muzika popullore, format muzikore.			

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore**Nxënësi/ja:**

- rikujton ritmet muzikore, format muzikore, muzika popullore, instrumentet muzikore etj., të klasës së 8-të;
- plotëson njohuritë muzikore duke verifikuar kujtesën dhe saktësinë lidhur me to;
- respekton mendimin e shokëve duke diskutuar njohuritë e veta muzikore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Teksti nxënësit: Art muzikor 9, QR code, CD, magnetofon, materiale nga teksti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shoqëria dhe shoqëria

Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve të simboleve “himn”, “gjuhë” “flamur” shkallët muzikore me dy shenja në armature, muzikë popullore etj.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një situatë diskutimi me nxënësit, duke nxitur sipas teknikës pyetje-përgjigje mbi njohuritë e marra në klasën e 8-të, p.sh.: ritëm i thjeshtë, ritëm i përbërë, instrumente muzikore, muzika popullore, duke vendosur vetëm fjalën në tabelë dhe nxënësit përgjigjen me një togfjalësh.

Ndërtimi i njohurive të reja

Vazhdohet puna konkursin mes dy skuadrave ku mësimdhënësi ka përgatitur një grup pyetjesh për të dyja skuadrat (pyetjet e mundshme për skuadrat).

- **Dëgjo** “Himni Kombëtar” dhe përcakto tonalitetin:
 - a. Do Maxhor b. Sol Maxhor c. Fa Maxhor
- Në shkallën Sol + dhe Fa + gjysmëtonet ndodhen në gradët:
 - a. 2-3 5-6 b. 4-5 6-7 c. 3-4 7-8
- **Rretho** përgjigjen e saktë.
- Masa 5/8 formohet nga
 - a. një masë e thjeshtë b. dy masa të thjeshta c. tri masa të thjeshta
- Masa 7/8 ka
 - a. 2 lëvizje dore b. 3 lëvizje dore c. 4 lëvizje dore
- Masa 9/8 formohet nga
 - a. dy masa të thjeshta b. tri masa të thjeshta c. katër masa të thjeshta

Rretho përgjigjen e saktë.

- Kënga polifonike këndohet në:
 - a) Shqipërinë e Veriut; b) Shqipërinë e Mesme; c) Shqipërinë e Jugut.

Plotëso fjalitë e mëposhtme.

Simbolet kombëtare të një vendi janë:

Plotëso vendet bosh në fjalitë e mëposhtme:

Shkalla maxhore me dy diezë është _____.

Shkalla maxhore me dy bemolë është _____.

Plotëso vendet bosh në fjalitë e mëposhtme

Pjesë e folklorit tonë muzikor janë:

1. _____ 2. _____ 3. _____

Këngët dhe vallet popullore ndahen në tri gjini:

1. _____ 2. _____ 3. _____

Plotëso vendet bosh në fjalitë e mëposhtme

Opera e parë shqiptare quhet dhe u kompozua nga kompozitori _____.

Baleti i parë shqiptar është _____.

Shkruaj deri në tre tituj këngësh nga muzika e kultivuar shqiptare.

1. _____

2. _____

3. _____

Shkruaj deri në katër emra të kompozitorëve shqiptarë, që kanë kompozuar muzikë për filma.

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

Demonstrimi i rezultateve të arritura përmes procesit të reflektimit

Nxënësit:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth pyetjeve gjatë konkursit;
- prezantojnë dhe përgjigjen për pyetjet e bëra lidhur me njohuritë e klasës së 8-të;
- vlerësojnë përgjigjen e shokëve gjatë konkursit.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: saktësinë e përgjigjeve lidhur me ritmet muzikore, format muzikore, muzika popullore, instrumentet muzikore etj., të klasës 8-të;

N3: plotësimin e njohurive muzikore duke verifikuar kujtesën dhe saktësinë lidhur me to;

N4: respektimin e mendimit e shokëve duke ndarë idenë e vet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për mënyrën e përgjigjeve që duhet të japin në konkursin e organizuar.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (rikujtimi mbi njohuritë muzikore të klasës së 8-të).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Arte		Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë			Rezultati i të nxënit të temës: - këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë, muzikë e popullarizuar etj.) sipas tekstit notal dhe imitimit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Këngë arbëreshe				
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.				
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi dhe Shoqëria dhe mjedisi Historia, faktet , heronjtë bëjnë atë që quhet Historia e një populli.				
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:				
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari bisedë me nxënësit, duke u kërkuar atyre të përshkruajnë se çfarë ata dinë për arbëreshët e Italisë apo për shqiptarët në diasporë duke zbuluar fakte, personazhe dhe data të rëndësishme për këtë luftë.				

Diskutohen faktet e sjella me njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Arbëreshe”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënës.

- I -

Vajta kalova gjith’ Kalabrinë
askund nuk gjeta si Arbërinë.

Vajta kalova gjith’ Kalabrinë
askund nuk gjeta si Shqipërinë.

- II -

Dy manushaqe në dorën time
ia zgjata njëren arb’reshes sime.

Dy manushaqe në dorën time
ia zgjata njëren arb’reshës sime.

- Refreni -

E lule-lu, e lule-lu,
e lule-lule maca e maca,
e un’ për ty, e un’ për ty,
e un’ për ty, o ndalu pace.
E ndalu pac’, e ndalu pac’,
e ndalu pac’ është e vërtetë,
se zemra im’, se zemra im’,
se zemra ime je ti vetë.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- ⊕ dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD;
- ⊕ procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- ⊕ demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- ⊕ këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- ⊕ mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;
- ⊕ mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- ⊕ interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- ⊕ këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- ⊕ përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave;
- ⊕ përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Reflektimi (10 minuta)

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar të me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në:

N2: diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re;

N2: këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;

N3: interpretimin e këngës me emocion;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup, korrekt në ritëm dhe në intonacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për dëgjimin (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Udhëzohen nxënësit për krijimin e një eseje duke shpjeguar përjetime të ndryshme.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE


Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (Nëntë)
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor		Rezultati i të nxënit të temës:	
Tema “Shkrim leximi muzikor”		1. njeh parimin e tonaliteteve të ndryshme muzikore dhe simbolet e tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):			
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.			
II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.			
II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.			
III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.			
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.			
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.			
V.2. Dëshmim i vetëbesimit.			
VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):			
RNE2.			
2.2. Përdorin në mënyrë efektive njohuritë e tyre mbi elementet, proceset dhe teknikat interpretuese dhe krijuese artistike duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Tonaliteti në muzikë			
Fjalët kyçe: tonalitet muzikor, tonika, maxhore, minore.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore			
Nxënësi/ja:			
- identifikon ndryshimet midis tonalitetit maxhor dhe minor nëpërmjet dëgjimit të veprave muzikore; - shpjegon tonalitetet muzikore maxhore dhe minore; - shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës sipas tonalitetit që ka vija melodike; - dëgjon dhe respekton punën e vet dhe të shokut.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:			
Teksti nxënësit, Art muzikor 9, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Matematika			
Përdorimi i shenjave dhe simboleve në një kontekst të dhënë.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Mësimi fillon me një brainstorming ku mësimdhënësi/ja vendos për të dëgjuar dy fragmente muzikore dhe kërkon nga nxënësit të evidentojnë gjatë dëgjimit ndryshimin që ndodh përgjatë melodisë.



Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Vazhdohet më tej veprimtaria, duke u shpjeguar nxënësve/eve njohuritë për tonalitetet muzikore të cilat mund të jenë maxhore dhe minore. Tonalitetet i kemi maxhore dhe minore, por ndryshojnë nga njëra tjetra nga lartësia e tingujve.


Numri i shenjave të shartimit diez ose bemol të vendosura pas çelësit përcaktojnë tonalitetin e një pjese muzikore. Emërtimi i tonalitetëve maxhore dhe minore bëhet duke u bazuar në notën e parë të shkallës në të cilën ndërtohet melodia apo rrokjen e parë të alfabetit muzikor.

Tonalitet emërtohen në bazë të emrit të shkallës apo duke i vendosur edhe shkronjën e alfabetit muzikor p.sh.: C-Dur, e-mol etj.

U shpjegohen rrethi i shkallëve muzikore të cilat janë edhe tonalitete muzikore. Ata provojnë të përcaktojnë tonalitetin në ushtrimet e dhëna në tekstin e tyre.

Reflektimi (10 minuta) – Teknika Diagrama e Venit

Nxënësit provojnë njohuritë e marra duke vendosur përmes teknikës së Diagramës së Venit.



Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: Identifikimin e ndryshimeve midis tonalitetit maxhor dhe minor nëpërmjet dëgjimit të veprave muzikore;

N3: Shpjegimin e tonalitetëve muzikore maxhore dhe minore;

N 4: Përcaktimin dhe shpjegimin e ndryshueshmërinë së muzikës sipas tonalitetit që ka vija melodike;

N4: Çmuarjen dhe respektimin e punës së vet dhe të shokut.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të krijojnë një melodi prej 16 masash, duke zgjedhur tonalitetin që ti dëshiron. Më pas këndoje krijimin tënd muzikor.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (Tonalitetet muzikore).


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor Tema "Elementet muzikore"		Rezultati i të nxënit të temës: 1. përdor në mënyrë efektive dhe të vetëdijshme e kreative, elementet e gjuhës muzikore (ritmet, meloditë) në këndim, luajtje në instrumente muzikore dhe krijim të tërësive të reja muzikore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9. iniciimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore; II.3. kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore; II.7. vlerësimi dhe vetëvlerësimi; III.4 identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme; III.5. mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive; IV.1. paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon; V.2. dëshmim i vetëbesimit; VI.1. kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF.2. 2.2 Përdorin në mënyrë efektive njohuritë e tyre mbi elementet, proceset dhe teknikat interpretuese dhe krijuese artistike duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Ushtrime këndimi”			
Fjalët kyçe: ritëm i thjeshtë, tonalitet, theks i fortë, theks i butë.			
Rezultati/ete të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - lexon ushtrime në ritmet e mësuara; - këndon sipas tonalitetit në ritmin 2/4, 3/4 dhe 4/4; - shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës sipas tonalitetit që ka vija melodike; - dëgjon dhe respekton punën e vet dhe të shokut.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 9, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Matematika Përdorimi i shenjave dhe simboleve në një kontekst të dhënë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta) Mësimi fillon me diskutime lidhur me ritmet e thjeshta, të përbëra dhe të përziera ku mësimdhënësi pyet lidhur me rrahjet, vlerat e notave brenda një mase muzikore etj.			
Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta) Vazhdohet më tej mësimi duke lexuar dhe kënduar sipas tonaliteteve që ka çdo ushtrim i dhënë në tekst. Gjatë këndimit të ushtrimeve rrethohet me ngjyrë pikërisht nota që pëson ndryshime/përdoret shenja e shartimit dhe ku melodia ndryshon.			

1

Moderato

"Mësuesit tim"

Muzika: N. Doko




O m'su - si im zem - ra më kën - don
se ti pa pu - shim di - je më dhu - ron
Ti gjith' buz - qesh - je ne na le - dha - ton
për t'ardh - men to - në me gjith' shpirt pu - non.

2

Allegretto

Popullore - Itali


Reflektimi (10 minuta)

Nxënësit këndojnë disa herë ushtrimet.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: Leximin e ushtrimeve në ritmet e mësuara.

N3: Këndimin në tonalitetet dhe në ritmin 2/4 dhe 4/4.

N4: Shpjegimin e ndryshueshmërisë së muzikës sipas tonalitetit që ka vija melodike.

N4: Çmuarjen dhe respektimin e punës së vet dhe të shokut.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të krijojnë ushtrime melodike në tonalitete të tjera muzikore duke i kënduar ato.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (Ushtrime në tonalitete të ndryshme).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (Nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Interpretim në instrumente		Rezultati i të nxënit të temës: 1. shoqëron këngët dhe luan pjesë instrumentale sipas imitimit ose me tekst notal, në zhanre të ndryshme, individualisht dhe në grupe.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF.1. I.1. krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Luajmë në instrument			
Fjalët kyçe: rregullat e luajtjes në instrument, ritëm.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore			
Nxënësi/ja: - luan apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara muzikore; - luan në instrument, duke respektuar rregullat e këtij instrumenti; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, instrumenti muzikor.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit, duke iu kërkuar atyre të rikujtojnë rregullat e luajtjes në instrumentin e fyellit dhe bërë nxehjen me të.			
Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta) Demonstrohet nga mësimdhënësi pastaj nga nxënësit ushtrimi Nr. 1 dhe pastaj ushtrimi Nr. 2. Mësimdhënësi kujdeset që fillimisht të shikohen mirë vendosja e gishtave sipas notave të secilit ushtrim.			

Ushtrim me instrumentin e bllokflautit duke u ushtruar.

Më pas vazhdohet ekzekutimi me ushtrimet e tjera që ka teksti ose ushtrime të sjella nga mësimdhënësi.

2
Moderato
Popullore - Arbëreshe

1
Allegro
Popullore

Reflektimi (10 minuta)

Më pas vazhdohet me ekzekutimin final të ushtrimeve që ka teksti.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve:

N2: demonstrimin me korrektësi të luajtjes së ritmeve apo simboleve të mësuara me instrument.

N3: ekzekutimin korrekt të notave muzikore me shenja shartimi në fyell/bllokflaut, duke respektuar rregullat e luajtjes.

N4: bashkëpunimin gjatë mëimit të ushtrimeve me fyell/bllokflaut).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për përsëritjen e ushtrimeve të tekstit në shtëpi.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema “Krijues dhe performues”		Rezultati i të nxënit të temës: 1. njeh zhvillimet që kanë ndikuar në paraqitjen dhe përsosjen e gjinive të caktuara muzikore në periudha të ndryshme; 2. njeh përfaqësuesit kryesorë të llojit/gjinisë muzikore dhe kontributin konkret të tij/saj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF. 3. Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor 3.1. Njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror. 3.2. Demonstron të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 3.3. Prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Niket Dardani dhe Jan Kukuzeli”			
Fjalët kyçe: mesjetë, mesha, himne, stil muzikor.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - njeh jetën dhe veprimtarinë e dy muzikantëve shqiptarë Niket Dardani dhe Jan Kukuzeli; - shpjegon zhvillimin e muzikës dhe veprat e muzikantëve shqiptarë, duke u ndalur në dy himne apo psalme; - krahason duke gjykuar mbi dy vepra muzikore të dy muzikantëve shqiptarë; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Artet, gjuha dhe letërsia Lidhja e njohurive muzikore të periudhës së mesjetës me letërsinë.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes brainstorming (vendosja e dy fotografive apo shkrimi i emrave të dy muzikantëve) ku mësimdhënësi nxit nxënësit të flasin rreth asaj që dinë rreth tyre.

Nxënësit diskutojnë në lidhje me të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Njohuritë e reja fillojnë me një hartë konceptesh duke vendosur fjalë kyçe:

Niket Dardani Ramesiana Jan Kukuzeli →

Pasi mbledh të dhënat nga nxënësit, mësimdhënësi fillon:

- shpjegimin mbi zhvillimin e muzikës dhe rolin e dy muzikantëve shqiptarë në muzikën kishtare.
- identifikimin dhe shpjegimin himneve, përmes dëgjimit të “Te Deum” – Niket Dardani.
- nxitjen e nxënësve për të bërë krahasimin midis psalmeve apo himneve që ata dëgjojnë;
- nxitjen dhe drejtimin për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi muzikën dhe veprimtarinë e dy muzikantëve shqiptarë nga interneti, dhe prezantimin e tyre në klasë.

Reflektimi: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi veprimtarinë e dy muzikantëve shqiptarë përmes një diagrame veni.



Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: Njohjen me jetën dhe veprimtarinë e dy muzikantëve shqiptarë Niket Dardani dhe Jan Kukuzeli.

N3: Shpjegimin e zhvillimit të muzikës dhe veprave të muzikantëve shqiptarë, duke u ndalur në dy himne apo psalme.

N4: Krahasimin duke gjykuar mbi dy vepra muzikore të dy muzikantëve shqiptarë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë dy himne dhe krijojnë një vlerësim të vetin për ta vendosur në portofol.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Artmuzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema: “Zhanret muzikore”		Rezultatit të nxënës të temës: - njih zhvillimet që kanë ndikuar në paraqitjen dhe përsosjen e gjinive të caktuara muzikore në periudha të ndryshme; - njih përfaqësuesit kryesorë të llojit/gjinisë muzikore dhe kontributin konkret të tij/saj.	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : RNF. 3. Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor. 3.1. njih në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror; 3.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlikues në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 3.3. prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Muzika dhe shoqëria në Mesjetë”			
Fjalët kyçe: mesjetë, koral Gregorian, neuma, tetragram, stil muzikor, polifoni, monofoni.			
Rezultati/e të nxënës për orën mësimore Nxënësi/ja: - jep kuptimin etimologjik mesjetë, stil muzikor, koral Gregorian, polifoni, monofoni, neuma etj.; - shpjegon zhvillimin e muzikës gjatë periudhës së mesjetës, duke u ndalur në momentet kryesore të kësaj periudhe; - shpjegon duke gjykuar mbi dy vepra muzikore të periudhës së mesjetës; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënës, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Artet, gjuha dhe letërsia

Lidhja e njohurive muzikore të periudhës së mesjetës me letërsinë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes **brainstorming** (**dëgjim** i fragmentit muzikor shkëputur nga “Deum verum”) ku mësuesi nxit nxënësit të përcaktojnë sa zëra dëgjojnë gjatë këndimit. Nxënësit diskutojnë në lidhje me të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Njohuritë e reja fillojnë me një **hartë konceptesh** duke vendosur fjalë kyçe:

Neumamuzika në mesjetëkorali gregorian Guido D’Areco

Pasi mbledh të dhënat nga nxënësit, mësuesi fillon:

- shpjegimin mbi zhvillimin e muzikës gjatë periudhës së mesjetës, përfaqësuesve dhe llojit të muzikës që u zhvillua;
- identifikimin dhe shpjegimin koralit gregorian përmes dëgjimit të koraleve të ndryshme;
- shpjegimin konkret përmes dëgjimit të polifonisë dhe monofonisë;
- nxitjen e nxënësve për të bërë krahasimin midis koraleve të ndryshme;
- nxitjen dhe drejtimin për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi muzikën e kësaj periudhe nga interneti, dhe prezantimin e tyre në klasë.

Reflektimi: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi zhanret muzikore përmes **teknikës së Klasterit**.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: kuptimin etermave mesjetë, stil muzikor, korali gregorian, polifoni, monofoni, neuma etj.;

N3: shpjegimin e zhvillimit të muzikës gjatë periudhës së mesjetës, duke u ndalur në momentet kryesore të kësaj periudhe;

N4: gjykimin e dy veprave muzikore të periudhës së mesjetës duke nxjerrë në pah karakteristikat.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë dy korale ose dy pjesë polifonike dhe krijojnë një vlerësim të vetin për ta vendosur në portofol.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Kreativitet muzikor.		Rezultati i të nxënit të temës: - krijon tërësi të reja muzikore në bazë të ritmit, tekstit poetik etj; - shfrytëzon teknologjinë bashkëkohore (dhe atë muzikore) sipas interesimit dhe prirjes për të performuar dhe krijuar shprehje.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive. II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.1. Mësimi për të mësuar/nxënë – vetorganizimi i të nxënit. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1 I.1. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Krijim muzikor			
Fjalët kyçe: krijim, tonalitet, tekst poetik.			
Rezultati/e të të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - punon krijimin e vet bazuar në njohuritë muzikore, mbi ritmet e mësuara dhe simbolet muzikore; - zhvillon në tonalitete të ndryshme muzikore krijimin e vet; - shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë tonalitetit të përzgjedhur dhe përdorimit të vlerave të ndryshme të notave dhe pushimeve; - respekton punën e vet dhe të shokut.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Mësimi fillon me një diskutim rreth kriterëve që duhen mbajtur parasysh gjatë krijimit muzikor. Mësimdhënësi kujton se:


krijimi i një vije melodike muzikore, që të quhet e tillë duhet të plotësojë disa kriterë. Ajo duhet:

1. të ketë tonalitetin muzikor, e cila bazohet në një nga shkallët e mësuara.
2. të zhvillohet në një nga ritmet muzikore (2/4, 3/4, 4/4 etj.).
3. të përdorim elemente muzikore të mësuara.
4. të pasurojmë vijën melodike, duke e shoqëruar me tekstin poetik të parapëlqyer.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)

Më pas vazhdohet duke orientuar nxënësit të krijojnë një kompozim të vetin (një melodi) ku të përdorësh elementet muzikore që ke mësuar:

- Përcakto tonalitetin muzikor.
- Përcakto ritmin muzikor 2/4, 3/4 ose 4/4.
- Përdor kombinime të gjatësive të ndryshme ritmike.
- Plotëso krijimin tënd muzikor me një tekst poetik të zgjedhur.
- Prezanto krijimin tënd muzikor, duke e kënduar atë.



Reflektimi (10 minuta)

Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin rreth krijimeve që ata kanë bërë në punimet e tyre, duke vlerësuar dhe respektuar punimet e njëri tjetrit.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve:

N2: Përgatitjen e krijimit të vet bazuar në njohuritë muzikore, mbi ritmet e mësuara dhe simbolet muzikore;

N3: Zhvillimin dhe këndimin e krijimit të vet në tonalitete të ndryshme muzikore;

N4 Shpjegimin e ndryshueshmërinë e muzikës gjatë tonalitetit të përzgjedhur dhe përdorimit të vlerave të ndryshme të notave dhe pushimeve;

N4: Respektimin e punës e vet dhe të shokut.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për çmuarjen e krijimit dhe respektimin e punimit të shokëve. Nxiten të zhvillojnë krijime të tjera duke i pasuruar portofolat e tyre.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë		Rezultati i të nxënit të temës: - këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë, muzikë e popullarizuar etj.) sipas tekstit notal dhe imitimit; - interpreton në performanca të ndryshme të kombinuara (muzikë, dramë, vallëzim).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF.1. 1. 1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kënga “Jeta kërkon dashuri”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, QR code, CD, magnetofon, materiale nga interneti.			
Fusha: Gjuhët dhe komunikimi: letërsia. Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “jeta”, “dashuri nënë”, “lumturi”.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari fillon mësimin me një brainstorming ku mësuesi/ja nxit përmes pyetjeve: Çfarë është dashuria e nënës për Ju? Sa e madhe është dashuria e saj ndaj fëmijëve? Nxënësve u kërkohet që të flasin lidhur me për emocionet që përcjell arti i fjalës dhe i melodisë. Diskutimet ndihmojnë që ata të kuptojnë vetë se sa të rëndësishme janë simbolet e një kombi.			

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Jeta kërkon dashuri” duke u mbështetur në stilin dëgjimor të nxënësve.

- I -

Se jeta ikën e jo nuk kthen,
dita pret diellin që sa po vjen,
ma jep ti dorën të lutem pak,
un’ ta jap zemrën në çast.

- II -

Zemrat kërkojnë veç dashuri,
jo lot në sy, nënat kërkojnë,
nga çdo njeri, nga çdo njeri
jeta kërkon dashuri.

- Refreni -

Kjo dashuri që sundon në këtë botë
duam të zgjohet tek çdo njeri,
duam që zemrat të kenë lumturi
ashtu si un’, ashtu dhe ti.
Hej, hej, jeta kërkon dashuri.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- ⌚ dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD;
- ⌚ procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- ⌚ demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- ⌚ këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- ⌚ mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;
- ⌚ mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- ⌚ interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- ⌚ këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.

Reflektimi (10 minuta)

- ⌚ Përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave.
- ⌚ Përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Gjatë mësimin të këngës, tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësve/es do të bëhet për rezultatet e arritura në:

N2: diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re.

N2: këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit.

N3: interpretimin e këngës me emocion.

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup, korrekt në ritëm dhe në intonacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Udhëzohen nxënësit për **çmuarjen dhe vlerësimin** e tekstit dhe melodisë së këngës.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (këndimin në ritëm dhe intonacion deri në përkryerje artistike).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema “Zhanret muzikore”		Rezultati i të nxënësve të temës: - njih zhvillimet që kanë ndikuar në paraqitjen dhe përsosjen e gjinive të caktuara muzikore në periudha të ndryshme; - njih përfaqësuesit kryesorë të llojit/gjinisë muzikore dhe kontributin konkret të tij/saj.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF. 3. Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor. 3.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror; 3.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., rilindje, baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 3.3. prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kultura muzikore gjatë Rilindjes			
Fjalët kyçe: rilindje, madrigali, kaça, balada, shkolla polifonike.			
Rezultati/e të të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: - jep kuptimin e termave rilindje dhe formave muzikore që u krijuan gjatë kësaj periudhe; - shpjegon zhvillimin e muzikës gjatë periudhës së rilindjes, duke u ndalur në momentet kryesore të kësaj periudhe; - shpjegon duke gjykuar mbi dy vepra muzikore të periudhës së rilindjes dhe përfaqësuesve; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënës, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Artet, gjuha dhe letërsia Lidhja e njohurive muzikore të periudhës së rilindjes me letërsinë.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes brainstorming, dëgjim i fragmentit muzikor të shkëputur nga “Ave Maria Stella” të Gijom Dyfej ku mësuesi nxit nxënësit të përcaktojnë shkurtimisht përjetimin muzikor. Nxënësit diskutojnë në lidhje me të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Njohuritë e reja fillojnë me një hartë konceptesh duke vendosur fjalë kyçe:

Madrigalimuzika në rilindje → kaça → balada → melodrama


Pasi mbledh të dhënat nga nxënësit, mësimezhënësi fillon:

- shpjegimin mbi zhvillimin e muzikës gjatë periudhës së rilindjes, përfaqësuesve dhe llojit të muzikës që u zhvillua;
- identifikimin dhe shpjegimin formave muzikore si madrigali, balada, kaça etj.,përmes dëgjimit të tyre;
- shpjegimin të karakteristikave të secilës nga format muzikore;
- nxitjen e nxënësve për të bërë krahasimin midis formave muzikore të ndryshme;
- nxitjen dhe drejtimin për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi muzikën e kësaj periudhe nga interneti, dhe prezantimin e tyre në klasë.

Reflektimi: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi format muzikore të periudhës së rilindjes.

Mund të zhvillohet edhe përmes Diagramës së Venit.



Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: kuptimin etermave rilindje, forma muzikore, melodramë etj.;

N3: shpjegimin e zhvillimit të muzikës gjatë periudhës së rilindjes, duke u ndalur në momentet kryesore të kësaj periudhe;

N4: gjykimin e dy veprave muzikore të periudhës së rilindjes duke nxjerrë në pah karakteristikat.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë dy korale ose dy forma muzikore (madrigali dhe baladën) dhe krijojnë një vlerësim të vetin për ta vendosur në portofol.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë		Rezultati i të nxënësve të temës: 1. këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë, muzikë e popullarizuar etj.) sipas tekstit notal dhe imitimit.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. 1.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kënga “Për ty Atdhe”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/e të të nxënësve për orë mësimore Nxënësi/ja: - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi dhe Shoqëria dhe mjedisi Kultura, identiteti kombëtar, gjuha, muzika etj.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari bisedë me nxënësit, duke u kërkuar atyre të flasin lidhur me atdheun ose dheun e të parëve. Diskutohet rreth kësaj teme.			

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Për ty atdhe”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënës.

- I -	për k'to fusha të gjana,	si një kështjell' e pamposhtur,
Për ty atdhe,	për kët'vënd,	ti qëndron.
ma të bukrën kang'	ku sot i lumtur jetoj.	Në mes dallgësh,
me fuqin' e k'saj zemre,	- II -	shkëmb graniti vigan,
do t'këndoj,	I bukur je,	s'u përkule,
për k'to male,	ngrihesh madhështor,	nga çdo stuhi e tufan.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- ⌚ dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD;
- ⌚ procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- ⌚ demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- ⌚ këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- ⌚ mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale;
- ⌚ mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- ⌚ interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- ⌚ këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- ⌚ përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave;
- ⌚ përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Reflektimi (10 minuta)

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në:

N2: diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re;

N2: këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;

N3: interpretimin e këngës me emocion;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup, korrekt në ritëm dhe në intonacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për dëgjimin (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Udhëzohen nxënësit për krijimin e një eseje duke shpjeguar përjetime të ndryshme.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE


Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema: “Zhanret muzikore”		Rezultatit të nxënësve të temës: 1. njeh zhvillimet që kanë ndikuar në paraqitjen dhe përsosjen e gjinive të caktuara muzikore në periudha të ndryshme; 2. njeh përfaqësuesit kryesorë të llojit/gjinisë muzikore dhe kontributin konkret të tij/saj.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
RNF. 3. Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor. 3.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror; 3.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., rilindja, baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 3.3. prezantoi disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njëësia mësimore: “Kultura muzikore gjatë Barokut”			
Fjalët kyçe: barok, koncerto grosso, oratorio, opera, baleti.			
Rezultati/e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: - jep kuptimin e termave barok, koncertogrosso, balet, oratorio, opera si forma muzikore që u krijuan gjatë kësaj periudhe; - shpjegon zhvillimin e muzikës gjatë periudhës së Barokut, duke u ndalur në momentet kryesore të kësaj periudhe; - shpjegon duke gjykuar mbi dy vepra muzikore të periudhës së Barokut dhe përfaqësuesve të saj; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Artet, gjuha dhe letërsia Lidhja e njohurive muzikore të periudhës së Barokut me letërsinë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes brainstorming (dëgjim i fragmentit muzikor të shkëputur të shkëputura nga Concerto Grosso “Katër stinët” e Vivaldit,			

ku mësuesi nxit nxënësit të përcaktojnë shkurtimisht përjetimin muzikor. Nxënësit diskutojnë në lidhje me të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)

Njohuritë e reja fillojnë me një hartë e mendjes duke vendosur fjalë kyçe:




Mësuesi bashkë me nxënësit shkruan të dhënat lidhur me koncerto grosso-n e Vivaldit. Më pas, mësimdhënësi fillon:

- shpjegimin mbi zhvillimin e muzikës gjatë periudhës së Barokut, përfaqësuesve dhe llojit të muzikës që u zhvillua;
- identifikimin dhe shpjegimin formave muzikore si koncerto grossos, operës, oratorios, baletit etj., përmes dëgjimit të tyre.
- shpjegimin të karakteristikave të secilës nga format muzikore dhe gjinive muzikore;
- nxitjen e nxënësve për të bërë krahasimin midis formave muzikore të ndryshme;
- nxitjen dhe drejtimin për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi muzikën e kësaj periudhe nga interneti, dhe prezantimin e tyre në klasë.

Reflektimi: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi format muzikore të periudhës së rilindjes.

Mund të zhvillohet edhe përmes Diagramës së Venit.



Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: kuptimin e termave Barok, forma muzikore, koncerto grosso, opera, balet etj.;

N3: shpjegimin e zhvillimit të muzikës gjatë periudhës së Barok, duke u ndalur në momentet kryesore të kësaj periudhe;

N4: gjykimin e dy veprave muzikore të periudhës së Barokut duke nxjerrë në pah karakteristikat;

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë dy kohë nga Stinët e Vivaldit, koncerto grosso-n (Pranvera dhe dimri) dhe krijojnë një përjetim të vetin për ta vendosur në portofol.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Arte		Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema “Krijuesdhe performues”			Rezultati i të nxënit të temës: 1. njeh krijuesit dhe performuesit e veprave muzikore artistike që dëgjon, nga literatura botërore e periudhave dhe stileve të ndryshme dhe nga krijimtaria kombëtare; 2. njeh, analizon dhe krahason veprat muzikore të dëgjuara, sipas karakteristikave themelore: formës, tonalitetit, stilit, periudhës, gjinisë/llojit, formacionit interpretues dhe krijuesve të tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.				
RNF. 3. Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor. 3.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror; 3.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., rilindje, baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 3.3. prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: “Përfaqësues dhe vepra muzikore”				
Fjalët kyçe: vepra muzikore, krijimtari artistike				
Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: • identifikon vepra muzikore të krijuara nga kompozitorë të ndryshëm, gjatë periudhës Barok përmes dëgjimit; • shpjegon karakteristikat e veprave muzikore të krijuara gjatë periudhës Barok; • shfaq parapëlqimin e vet për kompozitorin dhe veprën muzikore që i pëlqen më shumë, duke dëgjuar dhe argumentuar atë; • sjell informacione për krijuesit dhe interpretuesit më të njohur të muzikës të krijuar gjatë periudhës Barok; • respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve.				

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Teksti nxënësit, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet

Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko-kulturore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete (brainstorming), përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, gjatë 20-30 sekondave nga kompozitorë të periudhës Barok. Vendosen CD me fragmente muzikore ku nxënësit identifikojnë veprën apo kompozitorin. Ata/ato flasin rreth njohurive që kanë për këto vepra ose përfaqësues.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, me një teknikë Harta e të pyeturit ku mësimdhënësi paraqet lloje të ndryshme veprash muzikore, dhe u kërkon nxënësve/eve të flasin rreth veprave muzikore që dëgjojnë.

Vazhdohet me dëgjimin e disa fragmenteve muzikore dhe nxënësit dëgjojnë vepra 4 Stinët/oratorio Mesiahose Tokata në D minor, etj.

Ata flasin rreth përjetimit emocional dhe dëgjimor ndaj këtyre veprave, duke sjellë edhe fakte mbi kompozitorët.


Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet muzikore nëpërmjet teknikës

Diagrama e Venit ku vendosen dy kompozitorë të Barokut, duke diskutuar veçantat dhe të përbashkëtat e tyre.

Përgjigjet mund të jenë të ndryshme bazuar në:

- Violina
- Kombësia
- Format muzikore të krijuara

**Vlerësimi i nxënësve:**

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin e veprave muzikore të krijuara nga kompozitorë të ndryshëm, gjatë periudhës Barok përmes dëgjimit;

N3: shpjegimin e karakteristikave të veprave muzikore të krijuara gjatë periudhës Barok nga përfaqësues të ndryshëm;

N4: çmojnë kompozitorin dhe veprën muzikore që i pëlqen më shumë, duke argumentuar atë;

N4: prezantimin e punës mbi krijuesit më të njohur të muzikës të krijuar gjatë periudhës Barok.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë kompozime nga veprat e krijuesve të ndryshëm të periudhës Barok përdorimin e mediave (QR code, DVD, CD, magnetofon), grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë		Rezultati i të nxënit të temës: 1. këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë, muzikë e popullarizuar etj.) sipas tekstit notal dhe imitimit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathhtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kënga Kur bie fyelli e çiftelia			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore: - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi dhe Shoqëria dhe mjedisi Kultura, identiteti kombëtar, gjuha, muzika etj.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari bisedë me nxënësit, duke u kërkuar atyre të shkruajnë deri në 4 emra instrumentet muzikore popullore të krahinës tënde ose më gjerë. Po ti, a luan ndonjë instrument? Diskutohet rreth instrumenteve që prezantojnë me njëri-tjetrin.			

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Kur bien fyelli dhe çiftelia”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënës.

- I -

Kur bien fyelli, çiftelia,
natënderi von'
vet' nga zemra k'ndon malsia,
krenaria jon'.
Ti, o fyell' i barinjve,
bukur po ting'llon,
si kristalet nëpër kroje,
zëri yt buron.

- Refreni -

Bjeri çiftelis', o djal'
këng' e trimave t'ushtoj'
kur bien fyelli e çiftelia,
natën deri von'
vet' nga zemra k'ndon
malsia,
krenaria jon'.

- II -

Me dy tela çiftelie,
këngën do qëndis
do këndoj nëpër korije,
shkrepave t'malsis'.
Kënga ime dhe jehona,
malevet'ushtoj'
të gëzohen bjeshkët tona,
krenaria jon'.

- Refreni -

Bjeri çiftelis', o djal'...

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- ⊕ dëgjimi i vijës melodike të këngës përmes QR code;
- ⊕ procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- ⊕ demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- ⊕ këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga nxënësit;
- ⊕ mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale;
- ⊕ mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- ⊕ interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- ⊕ këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- ⊕ përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave.
- ⊕ përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Reflektimi (10 minuta)

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në:

N2: diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re;

N2: këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;

N3: interpretimin e këngës me emocion;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup, korrekt në ritëm dhe në intonacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR


Udhëzohen nxënësit për dëgjimin (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Udhëzohen nxënësit për krijimin e një eseje duke shpjeguar përjetime të ndryshme.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (Nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Interpretim në instrumente		Rezultati i të nxënit të temës: 1. shoqëron këngët dhe luan pjesë instrumentale sipas imitimit ose me tekst notal, në zhanre të ndryshme, individualisht dhe në grupe.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Luajmë në instrument			
Fjalët kyçe: rregullat e luajtjes në instrument, ritëm.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - luan apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara muzikore; - luan në grup dy instrumente, duke respektuar ritmin dhe intonacionin gjatë luajtjes; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, instrumenti muzikor.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit, duke u kërkuar atyre të rikujtojnë rregullat e luajtjes në instrumentin e fyellit dhe bërë nxemjen me të.			
Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta) Demonstrohet nga mësimdhënësi pastaj nga nxënësit ushtrimi Nr. 1 dhe 2 dhe pastaj ushtrimi me dy fyej Nr. 3. Mësimdhënësi kujdeset që fillimisht të shikohen mirë vendosja e gishtave sipas notave të secilit ushtrim.			
Ushtrim me instrumentin e bllok flautit duke u ushtruar. Më pas vazhdohet ekzekutimi me ushtrimet e tjera që ka teksti ose ushtrime të sjella nga mësimdhënësi.			



1 Allegro



2 Allegro

KANON



3

Melodi - Bulgare



Reflektimi (10 minuta)

Më pas vazhdohet me ekzekutimin final të ushtrimeve që ka teksti.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve:

N2: demonstrimin me korrektësi të luajtjes së ritmeve apo simboleve të mësuara me instrument;

N3: ekzekutimin korrekt të ushtrimit me dy fyej/bllokflaut, duke respektuar rregullat e luajtjes;

N4: bashkëpunimin gjatë mësimin të ushtrimeve me fyell/bllokflaut).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për përsëritjen e ushtrimeve të tekstit në shtëpi.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema: “Zhanret muzikore”		Rezultati i të nxënit të temës: 1. njeh zhvillimet që kanë ndikuar në paraqitjen dhe përsosjen e gjinive të caktuara muzikore në periudha të ndryshme; 2. njeh përfaqësuesit kryesorë të llojit/gjinisë muzikore dhe kontributin konkret të tij/saj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF. 3. Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor 3.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror; 3.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 3.3. prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Kultura muzikore gjatë Romantizmit”			
Fjalët kyçe: iluminizëm, klasicizëm, opera seria, opera bufa, simfoni.			
Rezultati/ete të nxënit për orën mësimore: - jep kuptimin etermave që përdoren gjatë klasicizmit opera seria, opera bufa, simfonia, si gjini dhe forma muzikore që u krijuan gjatë kësaj periudhe; - shpjegon zhvillimin e muzikës gjatë periudhës së klasicizmit, duke u ndalur në momentet kryesore të kësaj periudhe; - shpjegon duke gjykuar mbi dy vepra muzikore të periudhës së Klasicizmit dhe përfaqësuesve të saj; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënës, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Artet, gjuha dhe letërsia, historia dhe gjeografia Lidhja e njohurive muzikore të periudhës së klasicizmit me politikën, me artet, me letërsinë.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)


Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes brainstorming (dëgjim i fragmentit muzikor të shkëputur nga “Simfonia nr. 3, Heroike” e Bethovenit, ku mësuesi nxit nxënësit të përcaktojnë shkurtimisht përjetimin muzikor, por edhe një fakt interesant nga njohuritë që ke marrë në lëndën e historisë rreth Revolucionit Francez. Nxënësit diskutojnë në lidhje me të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Njohuritë ereja fillojnë me hartën e mendjes duke vendosur fjalë kyçe: klasicizëm.


Mësuesi bashkë me nxënësit shkruan disa të dhëna lidhur me periudhën e klasicizmit duke mbledhur të dhëna lidhur me këtë periudhë. Më pas, mësimdhënësi fillon:

- shpjegimin mbi zhvillimin e muzikës gjatë periudhës së klasicizmit, përfaqësuesve dhe llojit të muzikës që u zhvillua.
- shpjegimin gjinive dhe formave muzikore si opera bufa dhe opera seria, sonata, simfonia etj., përmes dëgjimit të tyre.
- shpjegimin të karakteristikave të secilës nga format muzikore dhe gjinive muzikore;
- nxitjen e nxënësve për të bërë krahasimin midis gjinive dhe formave muzikore të ndryshme;
- nxitjen dhe drejtimin për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi muzikën e kësaj periudhe nga interneti, dhe prezantimin e tyre në klasë.



Reflektimi: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi format muzikore të periudhës së Klasicizmit. Mund të zhvillohet edhe përmes Diagramës së Venit.



Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: kuptimin e termave Barok, forma muzikore, koncerto grosso, opera, balet etj.;

N3: shpjegimin e zhvillimit të muzikës gjatë periudhës së Barokut, duke u ndalur në momentet kryesore të kësaj periudhe;

N4: gjykimin e dy veprave muzikore të periudhës së Barokut duke nxjerrë në pah karakteristikat.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë dy kohë nga Stinët e Vivaldit, koncerto grosson (Pranvera dhe dimri) dhe krijojnë një përjetim të vetin për ta vendosur në portofol.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema “ Krijues dhe performues”		Rezultati i të nxënit të temës: 1. analizon dhe krahason rrethanat shoqërore historike që kane ndikuar në zhvillimin e stileve te ndryshme muzikore; 2. njeh krijuesit dhe performuesit e veprave muzikore artistike që dëgjojnë, nga literatura botërore e periudhave dhe stileve të ndryshme dhe nga krijimtaria kombëtare. 3. njeh, analizon dhe krahason veprat muzikore të dëgjuara, sipas karakteristikave themelore: formës, tonalitetit, stilit, periudhës, gjinisë/llojit, formacionit interpretues dhe krijuesve të tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF. 3. Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor 3.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror; 3.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 3.3. prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar. RNF.4. Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike. 1.1. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike. 1.2. Përjeton, analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike elementet karakteristike dalluese të kryeveprave artistike të trashëgimisë kulturore dhe artistike (muzikore, pamore, dramë, vallëzim) në kontekst kombëtar dhe më të gjerë. 1.3. Çmon diversitetin kulturor ne rajon dhe më gjerë.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Përfaqësues dhe vepra muzikore”			
Fjalët kyçe: vepra muzikore, krijimtari artistike			

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- identifikon vepra muzikore të krijuara nga kompozitorë të ndryshëm, gjatë periudhës së klasicizmit përmes dëgjimit;
- shpjegon karakteristikat e veprave muzikore të krijuara gjatë periudhës së klasicizmit;
- shfaq parapëlqimin e vet për kompozitorin dhe veprën muzikore që i pëlqen më shumë, duke dëgjuar dhe argumentuar atë;
- sjell informacione për krijuesit dhe interpretuesit më të njohur të muzikës të krijuar gjatë periudhës së klasicizmit;
- respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Teksti nxënësit, Art muzikor 9, CD, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet

Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko-kulturore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete një teknikë “Harta e të pyeturit” ku mësimdhënësi paraqet emra të kompozitorëve nga klasicizmi dhe u kërkon nxënësve/eve të flasin rreth tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, me dëgjimin e veprave të përzgjedhura nga mësimdhënësi ose të sugjeruara nga teksti i nxënësit.

MOXART

KOMPOZITORË

HAJDEN

BETHOVEN

Veprat e sugjeruara janë:


- fragmenti muzikor nga vepra “Serenata nr. 5” e F. J. Hajden.
- aria “Mbretëresha e natës” nga opera “Flauti magjik” e V. A. Moxart.
- fragmenti muzikor nga “Sonata nr. 3 për piano” e L. V. Bethoven

Ata flasin rreth përjetimit emocional dhe dëgjimor ndaj këtyre veprave, duke sjellë edhe fakte mbi kompozitorët apo interpretuesit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet muzikore nëpërmjet teknikës Diagrama e Venit ku vendosen dy kompozitorë të Klasicizmit, duke diskutuar veçantat dhe të përbashkëtat e tyre.

Përgjigjet mund të jenë të ndryshme:



Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin e veprave muzikore të krijuara nga kompozitorë të ndryshëm, gjatë periudhës së Klasicizmit përmes dëgjimit;

N3: shpjegimin e karakteristikave të veprave muzikore të krijuara gjatë periudhës së Klasicizmit nga përfaqësues të ndryshëm;

N4: çmojnë kompozitorin dhe veprën muzikore që i pëlqen më shumë, duke argumentuar atë;

N4: prezantimin e punës mbi krijuesit më të njohur të muzikës të krijuar gjatë periudhës Barok.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë kompozime nga veprat e krijuesve të ndryshëm të periudhës klasike, përdorimin e mediave (DVD, CD, magnetofon), grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet;

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Kreativitet muzikor		Rezultatit të nxënësve të temës: 1. krijon tërësi të reja muzikore në bazë të ritimit, tekstit poetik etj; 2. shfrytëzon teknologjinë bashkëkohore (dhe atë muzikore) sipas interesimit dhe prirjes për të performuar dhe krijuar shprehje.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive. II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.1. Mësimi për të mësuar/nxënë – vetorganizimi i të nxënësve. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF.1. 1.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathhtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj. RNF.4. Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike. 1.1. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Intervista muzikore			
Fjalët kyçe: krijim, pikturë.			
Rezultati/ete të nxënësve për orë mësimore Nxënësi/ja: - punon krijimin e vet, bazuar në njohuritë muzikore, mbi ritmet e mësuara dhe simbolet muzikore; - zhvillon në tonalitet të ndryshme muzikore krijimin e vet; - shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë tonalitetit të përzgjedhur dhe përdorimit të vlerave të ndryshme të notave dhe pushimeve; - respekton punën e vet dhe të shokut.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Mësimi fillon me një diskutim rreth kriterëve që duhen mbajtur parasysh gjatë intervistave në lidhje me një çështje të caktuar. Intervista 1 kërkon të mbledhë informacion në lidhje me interesin ndaj muzikës. Për të marrë një informacion sa më të saktë duhen pyetur njerëz të gjeneratave të ndryshme.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)

Fillohet duke orientuar nxënësit si të ndahen në grupe (bazuar në numrin e nxënësve që ka klasa krijohen grupet) për të zhvilluar intervistat, por edhe për të plotësuar "fjalëkryqin". Intervista zhvillohet e para në komunitetet ku jetojnë por ndoshta edhe përtej.

Prezantohen rezultatet e intervistave.

Plotësohet "fjalëkryqin" brenda një kohe të përcaktuar, duke nxjerrë skuadrën fituese.

				M	S		N	E	T	A								
		I			R		V			O								
P		E			A		S			M	F		N		K	E		
		S			I		A											
		O	P		R							O	P			E		A
K			C	F	O	T	I	A			S	B	L	I		D		K
			M	P			L			I		T		K	A			
					F			T			I							
		I			R		U											
			R			R	T		T	N		I						
					V		K		R									
									L	E								

SINFONIA
POEMA SINFONIKE
INPROVIZO
SONATA
KONCERT SOLISTIK
FANTAZIA

PRELUDI
OPERA
SUITA
MINVETI
OPERETA
BALADA

TOKATA
VOKALE
ORATORIO
INSTRUMENTI
RECITATIVI

Reflektimi (10 minuta)

Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin rreth krijimeve që ata kanë bërë në punimet e tyre, duke vlerësuar dhe respektuar punimet e njëri tjetrit.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve:

N2: përgatitjen e krijimit të vet bazuar në njohuritë muzikore;

N3: zhvillimin dhe prezantimin e krijimit të vet;

N4 shpjegimin e dhënies së mendimeve në lidhje me muzikën dhe komunitetin që e dëgjon;

N4: respektimin e punës e vet dhe të shokut.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për çmuarjen e krijimit dhe respektimin e punimit të shokëve. Nxiten të zhvillojnë krijime të tjera duke i pasuruar portofolet e tyre.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema “Krijues dhe performues”		Rezultati i të nxënit të temës: 1. njeh zhvillimet që kanë ndikuar në paraqitjen dhe përsosjen e gjinive të caktuara muzikore në periudha të ndryshme; 2. njeh përfaqësuesit kryesorë të llojit/gjinisë muzikore dhe kontributin konkret të tij/saj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF. 3. Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor 3.1. Njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror. 3.2. Demonstron të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 3.3. Prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Interpretues shqiptarë”			
Fjalët kyçe: performim, instrument,			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - njeh jetën dhe veprimtarinë e dy muzikantëve kosovarë; - liston disa vepra muzikore të krijuara nga muzikantë kosovarë, duke u ndalur në dy prej tyre; - krahason duke gjykuar mbi dy vepra muzikore të dy muzikantëve kosovarë; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Artet, gjuha dhe letërsia Lidhja e njohurive muzikore të periudhës së mesjetës me letërsinë.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes brainstorming (vendosja e dy fotografive apo shkrimi i emrave të dy muzikantëve) ku mësimdhënësi nxit nxënësit të flasin rreth asaj që dinë rreth tyre.

Nxënësit diskutojnë në lidhje me të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)

Njohuritë e reja fillojnë me një diskutim dhe shikim fotosh të instrumentistëve të ndryshëm kosovarë (Blerim Grubi, Visar Kuçi dhe Venera Kajtazi).

Pasi mbledh të dhënat nga nxënësit, mësimdhënësi fillon:

- shpjegimin mbi veprimtarinë koncertore të instrumentistëve kosovarë.
- diskutimin mbi interpretimin nga koncerte të ndryshme të instrumentistëve kosovarë.
- nxitjen e nxënësve për të bërë krahasimin mbi interpretimin e instrumentistëve kosovarë;
- nxitjen dhe drejtimin për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi veprimtari të ndryshme të instrumentistëve kosovarë nga interneti, dhe prezantimin e tyre në klasë.

Reflektimi: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra për instrumentistët kosovarë.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: Njohjen me jetën dhe veprimtarinë e instrumentistëve kosovarë.

N3: Shpjegimin mbi interpretimin nga koncerte të ndryshme të instrumentistëve kosovarë.

N4: Krahasimin duke gjykuar mbi interpretimin në koncerte të ndryshme të instrumentistëve kosovarë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë dy himne dhe krijojnë një vlerësim të vetin për ta vendosur në portofol.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema “ Zhanret muzikore”		Rezultati i të nxënit të temës: 1. dallon zhanrin muzikor të këngëve dhe veprave muzikore që performon dhe dëgjon, identifikon qartë elementet përcaktuese të zhanrit të caktuar muzikor; 2. analizon dhe krahason rrethanat shoqërore historike që kanë ndikuar në zhvillimin e stileve të ndryshme muzikore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF. 3. Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjellas në kontekstin historik, social dhe kulturor. 3.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror; 3.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 3.3. prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Kultura muzikore gjatë Romantizmit”			
Fjalët kyçe: Romantizëm, muzika pianistike, muzika instrumentale, shkollat kombëtare.			
Rezultati/ete të nxënit për orën mësimore: - jep kuptimin etermave që përdoren gjatë romantizmit muzika pianistike, kënga, opera, si gjini dhe forma muzikore që u krijuan gjatë kësaj periudhe; - shpjegon zhvillimin e muzikës gjatë periudhës së romantizmit, duke u ndalur në momentet kryesore të kësaj periudhe; - shpjegon duke gjykuar mbi dy vepra muzikore të periudhës së romantizmit dhe përfaqësuesve të saj; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënës, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Artet, gjuha dhe letërsia, historia dhe gjeografia

Lidhja e njohurive muzikore të periudhës së romantizmit me politikën, me artet, me letërsinë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes brainstorming (dëgjim i fragmentit muzikor të shkëputur nga “Vallet hungareze” të kompozitorit Johan Brahms ku mësuesi nxit nxënësit të përcaktojnë shkurtimisht përjetimin muzikor. Nxënësit diskutojnë në lidhje me të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Njohuritë e reja fillojnë me një hartë të mendjes, duke vendosur fjalë kyçe:


Mësuesi bashkë me nxënësit shkruan disa të dhëna lidhur me periudhën e romantizmit, duke mbledhur të dhëna lidhur me këtë periudhë. Më pas, mësimdhënësi fillon:

- shpjegimin mbi zhvillimin e muzikës gjatë periudhës së romantizmit, përfaqësuesve dhe llojit të muzikës që u zhvillua;
- shpjegimin gjinive dhe formave muzikore përmes dëgjimit të tyre;
- shpjegimin të karakteristikave të secilës nga format muzikore dhe gjinive muzikore;
- nxitjen e nxënësve për të bërë krahasimin midis gjinive dhe formave muzikore të ndryshme;
- nxitjen dhe drejtimin për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi muzikën e kësaj periudhe nga interneti, dhe prezantimin e tyre në klasë.

Reflektimi: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi format muzikore të periudhës së romantizmit.

Mund të zhvillohet edhe përmes DDM. Ata plotësojnë fishën me njohuritë e marra mbi Romantizmin.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: kuptimin e termave romantizëm, muzikë instrumentale, muzikë vokale etj.;

N3: shpjegimin e zhvillimit të muzikës gjatë periudhës së romantizmit, duke u ndalur në momentet kryesore të kësaj periudhe;

N4: gjykimin e dy veprave muzikore të periudhës së romantizmit, duke nxjerrë në pah karakteristikat;

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë Nokturn nga Chopin dhe krijojnë një përjetim të vetin për ta vendosur në portofol.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema “Krijues dhe performues”		Rezultati i të nxënit të temës: 1. njeh krijuesit dhe performuesit e veprave muzikore artistike që dëgjojnë, nga literatura botërore e periudhave dhe stileve të ndryshme dhe nga krijimtaria kombëtare; 2. njeh, analizon dhe krahason veprat muzikore të dëgjuara, sipas karakteristikave themelore: formës, tonalitetit, stilit, periudhës, gjinisë/ llojit, formacionit interpretues dhe krijuesve të tyre; 3. shprehet për karakteristikat e veprës muzikore (formën, llojin, zhanrin përmbajtjen) me komentim, me shkrim, forma vizuale, prezantim me teknologji bashkëkohore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF. 3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme. RNF.4. Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike. 1.1. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike. 1.2. Përjeton, analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike elementet karakteristike dalluese të kryeveprave artistike të trashëgimisë kulturore dhe artistike (muzikore, pamore, dramë, vallëzim) në kontekst kombëtar dhe më të gjerë. 1.3. Çmon diversitetin kulturor në rajon dhe më gjerë.			
ASPEKTET SPECIFIK E TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Përfaqësues dhe vepra muzikore”			
Fjalët kyçe: vepra muzikore, krijimtari artistike.			
Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore: • identifikon vepra muzikore të krijuara nga kompozitorë të ndryshëm, gjatë periudhës së romantizmit përmes dëgjimit; • shpjegon karakteristikat e veprave muzikore të krijuara gjatë periudhës së romantizmit; • shfaq parapëlqimin e vet për kompozitorin dhe veprën muzikore që i pëlqen më shumë, duke dëgjuar dhe argumentuar atë;			

- sjell informacione për krijuesit dhe interpretuesit më të njohur të muzikës të krijuar gjatë periudhës së romantizmit;
- respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Teksti nxënësit, Art muzikor 9, CD, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet

Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko-kulturore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete një teknikë “Harta e të pyeturit” ku mësimdhënësi paraqet emra të kompozitorëve nga romantizmi dhe u kërkon nxënësve/eve të flasin rreth tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, me dëgjimin e veprave të përzgjedhura nga mësimdhënësi ose të sugjeruara nga teksti i nxënësit.

Veprat e sugjeruara janë:


- fragmentin muzikor nga “Serenata” e F. Schubertit dhe përshkruaj ndjesitë që të krijohen.
- fragmentin muzikor nga “Nokturn op. 9 nr. 2” të F. Chopin .
- fragmentin muzikor nga suita “Liqeni i mjelmave” të P. I. Çajkovski.
- fragmentin “Campanella” nga F. Liszt.

Nxënësit flasin rreth përjetimit emocional dhe dëgjimor ndaj këtyre veprave, duke sjellë edhe fakte mbi kompozitorët apo interpretuesit.

Nxënësit krahasojnë dy vepra muzikore të njëjtes gjini, nga kompozitorë të ndryshëm.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet muzikore nëpërmjet teknikës Diagrama e Venit ku vendosen dy kompozitorë të Romantizmit, duke diskutuar veçantat dhe të përbashkëtat e tyre.



Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin e veprave muzikore të krijuara nga kompozitorë të ndryshëm, gjatë periudhës së Romantizmit përmes dëgjimit;

N3: shpjegimin e karakteristikave të veprave muzikore të krijuara gjatë periudhës së Romantizmit nga përfaqësues të ndryshëm;

N4: çmojnë kompozitorin dhe veprën muzikore që i pëlqen më shumë, duke argumentuar atë;

N4: prezantimin e punës mbi krijuesit më të njohur të muzikës të krijuar gjatë periudhës së Romantizmit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë kompozime nga veprat e krijuesve të ndryshëm të periudhës së Romantizmit përdorimin e mediave (DVD, CD, magnetofon), grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet;

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (Nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë		Rezultati i të nxënit të temës: 1. këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë, muzikë e popullarizuar etj.) sipas tekstit notal dhe imitimit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj. RNF.4. Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kënga “La donna e mobile”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, CD, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi Njohja me gjuhën e huaj dhe zhvillimi i aftësive gjuhësore dhe kulturore.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari bisedë me nxënësit, duke u kërkuar atyre të flasin lidhur me kompozitorin Xhuzeppe Verdi.

Diskutohet rreth kësaj teme.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “La donna è mobile”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënësit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- ⌚ dëgjimi i vijës melodike të aries në CD;
- ⌚ procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga aria);
- ⌚ demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar arien;
- ⌚ këndimi i aries sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- ⌚ mësimi i melodisë së aries me rrokje neutral;
- ⌚ mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- ⌚ interpretimi dhe ndjekja e ritmit të aries në partiturë;
- ⌚ këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- ⌚ përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave;
- ⌚ përkryerja artistike e aries: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

La donna è mobile
qual piuma al vento,
muta d'accento
e di pensiero.
Sempre un amabile,
leggiadro viso,
in pianto o in riso,
è menzognero.
La donna è mobil
qual piuma al vento,
muta d'accento
e di pensier.

Reflektimi (10 minuta)

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuaratë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e aries në ritëm dhe intonacion.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në:

N2: diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me arien;

N2: këndimin korrekt të aries në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;

N3: interpretimin e aries me emocion;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup, korrekt në ritëm dhe në intonacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për dëgjimin (disa herë të aries) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Udhëzohen nxënësit për krijimin e një eseje duke shpjeguar përjetime të ndryshme.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (Nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema “ Krijues dhe performues”		Rezultati i të nxënit të temës: 1. Njeh krijuesit dhe performuesit e veprave muzikore artistike që dëgjon, nga literatura botërore e periudhave dhe stileve të ndryshme dhe nga krijimtaria kombëtare. 2. Njeh, analizon dhe krahason veprat muzikore të dëgjua, sipas karakteristikave themelore: formës, tonalitetit, stilit, periudhës, gjinisë/llojit, formacionit interpretues dhe krijuesve të tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 3. Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor 3.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror; 3.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 3.3. prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Krijues shqiptarë”			
Fjalët kyçe: interpretim, performim, përkryerje artistike.			
Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - identifikon përfaqësues dhe interpretues të muzikës shqiptare/kosovare përmes dëgjimit; - shpjegon veprat dhe instrumentet muzikore që interpretuesit luajnë në shfaqje të ndryshme muzikore; - shfaq parapëlqimin e vet për instrumentin që i pëlqen më shumë, duke dëgjuar dhe argumentuar shembuj të ndryshëm muzikorë; - sjell informacione për krijuesit dhe interpretuesit më të njohur të muzikës shqiptare; - respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet

Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko-kulturore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete (brainstorming), përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, gjatë 20-30 sekondave nga interpretues dhe vepra të ndryshme instrumentale. Vendosen QR code, me fragmente muzikore që luhen me instrumente, të cilat nxënësit i identifikojnë kompozitorët. Ata/ato flasin rreth njohurive që kanë për këta artistë.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, me një teknikë Harta e të pyeturit ku mësimdhënësi paraqet lloje të ndryshme veprash muzikore, dhe u kërkon nxënësve/eve të flasin rreth veprave muzikore që dëgjojnë të sugjeruara përmes tekstit të nxënësit.


Vazhdohet me dëgjimin e veprave muzikore (muzikë filmi, apo vepra të tjera).

Ata flasin rreth përjetimit emocional dhe dëgjimor ndaj këtyre veprave, duke sjellë edhe fakte mbi kompozitorët shqiptarë dhe kosovarë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet muzikore nëpërmjet teknikës Diagrama e Venit, ku vendosen dy kompozitorë të njohur shqiptarë /kosovarë duke diskutuar të veçantat dhe të përbashkëta të tyre. Përgjigjet mund të jenë të ndryshme:

- Violina
- Kombësia
- Virtuoziteti
- Motive folklorik shqiptare

**Vlerësimi i nxënësve:**

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

- dëgjimin e veprave muzikore, duke bërë listuar përfaqësuesit shqiptarë krijues që kanë dhënë kontributin e tyre;
- shpjegimin e veprave që dëgjon duke thënë pse i pëlqen luajtja në një instrument të caktuar;
- grumbullimin dhe prurjen në klasë me CD/DVD të veprave muzikore të krijuara apo luajtura nga shqiptarë/kosovarë;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë interpretime nga repertori i krijuesve të ndryshëm shqiptarë dhe kosovarë, përdorimin e mediave (DVD, CD, magnetofon), grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet;

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema “ Zhanret muzikore”		Rezultatii të nxënit të temës: 3. njeh zhvillimet që kanë ndikuar në paraqitjen dhe përsosjen e gjinive të caktuara muzikore në periudha të ndryshme. 4. njeh përfaqësuesit kryesorë të llojit/gjinisë muzikore dhe kontributin konkret të tij/saj; 5. analizon dhe krahason rrethanat shoqërore dhe historike që kanë ndikuar në zhvillimin e stileve të ndryshme muzikore. 6. Njeh krijuesit dhe performuesit e veprave muzikore artistike që dëgjojnë, nga literatura botërore e periudhave dhe stileve të ndryshme dhe nga krijimtaria kombëtare.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF. 3. Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor. 3.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror; 3.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 3.3. prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Muzika në shekullin XIX/XX

Fjalët kyçe: verizmi, impresionizmi, ekspresionizmi.

Rezultati/ete të nxënit për orën mësimore:

Nxënësi/ja:

- jep kuptimin etermave që përdoren gjatë shek. XIX-XX si gjini dhe forma muzikore që u krijuan gjatë kësaj periudhe;
- shpjegon zhvillimin e muzikës gjatë periudhës së postromantizmit (shek.XIX), duke u ndalur në momentet kryesore të kësaj periudhe;
- shpjegon duke gjykuar mbi dy vepra muzikore të periudhës së romantizmit dhe përfaqësuesve të saj;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Teksti nxënësit, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Artet, gjuha dhe letërsia, historia dhe gjeografia

Lidhja e njohurive muzikore të periudhës së romantizmit me politikën, me artet, me letërsinë.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes brainstorming(dëgjim i fragmentit muzikor të shkëputur nga “Rapsodia blu” e kompozitorit, Xhorxh Gershvin, dhe fragment nga “Sonata e hënës” e Bethovenit, ku mësuesi nxit nxënësit të përcaktojnë shkurtimisht përjetimin muzikor. Nxënësit diskutojnë në lidhje me të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Njohuritë e reja fillojnë me një hartë të mendjes duke vendosur fjalë kyçe:


Mësuesi bashkë me nxënësit shkruan disa të dhëna lidhur me periudhën e shek.XIX-XX, duke mbledhur të dhëna lidhur me këtë periudhë. Më pas, mësuesi fillon:

- shpjegimin mbi zhvillimin e muzikës gjatë periudhës së postromantizmit, dhe më pas shekullin e 20-të, përfaqësuesve dhe llojit të muzikës që u zhvillua;
- shpjegimin gjinive dhe formave muzikore përmes dëgjimit të tyre;
- shpjegimin të karakteristikave të secilës nga format muzikore dhe gjinive muzikore;
- nxitjen e nxënësve për të bërë krahasimin midis gjinive dhe formave muzikore të ndryshme;
- nxitjen dhe drejtimin për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi muzikën e kësaj periudhe nga interneti, dhe prezantimin e tyre në klasë.

Reflektimi: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi format muzikore të periudhës së shek.XIX-XX.

Mund të zhvillohet edhe përmes diagramës së Venit.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: kuptimin e termave impresionizëm, ekspresionizëm, verizëm, muzikë instrumentale, muzikë vokale etj.;

N3: shpjegimin e zhvillimit të muzikës gjatë periudhës së shek.XIX-XX, duke u ndalur në momentet kryesore të kësaj periudhe;

N4: gjykimin e dy veprave muzikore të periudhës së shekullit XIX-XX, duke nxjerrë në pah karakteristikat.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë dy vepra muzikore Gershvin dhe Debysi dhe krijojnë një përjetim të vetin për ta vendosur në portofol.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (Nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema “ Krijues dhe performues”		Rezultati i të nxënit të temës: 7. Njeh krijuesit dhe performuesit e veprave muzikore artistike që dëgjon, nga literatura botërore e periudhave dhe stileve të ndryshme dhe nga krijimtaria kombëtare. 8. Njeh, analizon dhe krahason veprat muzikore të dëgjuara, sipas karakteristikave themelore: formës, tonalitetit, stilit, periudhës, gjinisë/llojit, formacionit interpretues dhe krijuesve të tyre.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

- I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
 I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
 II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
 III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
 III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
 IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
 V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
 VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

- 3.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror;
 3.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile).
 3.3. prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përfaqësues dhe vepra

Fjalët kyçe: interpretim, performim, përkryerje artistike

Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore**Nxënësi/ja:**

- identifikon përfaqësues dhe interpretues të muzikës shqiptare/kosovare përmes dëgjimit;
- shpjegon veprat dhe instrumentet muzikore që interpretuesit luajnë në shfaqje të ndryshme muzikore;
- shfaq parapëlqimin e vet për instrumentin që i pëlqen më shumë, duke dëgjuar dhe argumentuar shembuj të ndryshëm muzikorë;
- sjell informacione për krijuesit dhe interpretuesit më të njohur të muzikës shqiptare;
- respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Teksti nxënësit, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet

Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko-kulturore.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete (brainstorming), përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, gjatë 20-30 sekondave nga fragmentin për klarinetë dhe piano “Avazi i Tanës” i kompozitorit R. Rudi. Ata/ato flasin rreth njohurive që kanë për këtë artist.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, me një teknikë


Harta e të pyeturit, ku mësimdhënësi

paraqet foto të kompozitorëve dhe me dëgjim vepramuzikore,

duke u kërkuar nxënësve/eve të flasin rreth veprave muzikore që dëgjojnë të sugjeruara përmes tekstit të nxënësit.

Vazhdohet me dëgjimin e veprave muzikore (muzikë filmi, piano, violinë, klarinetë etj.).

Ata flasin rreth përjetimit emocional dhe dëgjimor ndaj këtyre veprave, duke sjellë edhe fakte mbi kompozitorët apo interpretuesit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)**

Përsëritin njohuritë e marra mbi jetën dhe veprat e kompozitorëve ku vendosen dy emra të dy kompozitorëve të njohur shqiptarë duke diskutuar veçantat dhe të përbashkëtat e tyre.

Përgjigjet mund të jenë të ndryshme:

- Stilistika
- Gjinia
- Kombësia
- Virtuoziteti
- Motive folklorik shqiptare

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

- dëgjimin e veprave muzikore, duke bërë listuar përfaqësuesit shqiptarë krijues dhe interpretues që kanë dhënë kontributin e tyre;
- shpjegimin e veprave që dëgjon duke thënë pse i pëlqen luajtja në një instrument të caktuar;
- grumbullimin dhe prurjen në klasë me CD/DVD të veprave muzikore të krijuara apo luajtura nga shqiptarë/kosovarë;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë interpretime nga repertori i krijuesve të ndryshëm shqiptarë dhe kosovarë përdorimin e mediave (DVD, CD, magnetofon), grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (Nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Interpretim në instrumente		Rezultati i të nxënit të temës: - shoqëron këngët dhe luan pjesë instrumentale sipas imitimit ose me tekst notal, në zhanre të ndryshme, individualisht dhe në grupe.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturoredhe shoqërore.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNE.1. Nxënësit, sipas prires, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Luajmë në instrument			
Fjalët kyçe: lojë në instrument, ritëm, intonacion.			
Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: • luan në instrument duke respektuar simbolikat e mësuara muzikore; • luan në grup dy instrumente, duke respektuar ritmin dhe intonacionin gjatë luajtjes; • respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; • ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, instrumenti muzikor.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit, duke iu kërkuar atyre të rikujtojnë rregullat e luajtjes në instrumentin e fyellit dhe bërë nxemjen me të.			
Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta) Demonstrohet nga mësimdhënësi pastaj nga nxënësit ushtrimi Nr. 1 me dy fyej dhe ushtrimi Nr. 2 me tre fyej. Mësimdhënësi kujdeset që fillimisht të shikohen mirë vendosja e gishtave sipas notave të secilit ushtrim.			
Ushtrim me instrumentin e bllokflautit duke u ushtruar.			

1 Delja rudë

Blokflaut 1

Blokflaut 2

2 Për mëmëdhenë

Blokflaut 1

Blokflaut 2

Blokflaut 3

Më pas vazhdohet ekzekutimi me ushtrimet e tjera që ka teksti ose ushtrime të sjella nga mësime të mësimdhënësi.

Reflektimi (10 minuta)

Më pas vazhdohet me ekzekutimin final të ushtrimeve që ka teksti.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve:

N2: demonstrimin me korrektësi të luajtjes së ritmeve apo simboleve të mësuara me instrument;

N3: ekzekutimin korrekt të ushtrimit me dy dhe trefje/blokflaut, duke respektuar rregullat gjatë luajtjes.

N4: bashkëpunimin gjatë mësimit të ushtrimeve me fyell/blokflaut).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për përsëritjen e ushtrimeve të tekstit në shtëpi.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë		Rezultati i të nxënit të temës: 9. këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë, muzikë e popullarizuar etj.) sipas tekstit notal dhe imitimit; 10. vlerëson këndimin dhe interpretimin e vet dhe të tjerëve duke përdorur saktë shprehjet dhe elementet e performimit cilësor muzikor.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathhtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kënga “Njerëzit e agimeve”			
Fjalët kyçe: Tekst i këngës, melodi, interpretim			
Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore: - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi dhe Shoqëria dhe mjedisi Kultura, puna, mjetet e punës, institucionet në industri etj.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari bisedë me nxënësit, duke u kërkuar atyre të flasin lidhur me: Çfarë dua unë të bëhem në të ardhmen? Si do t'i shërbej vendit tim sa më mirë.

Diskutohet rreth kësaj teme.

- I - Mir'mëngjes, mir'mëngjes dit' e bukur kaltëron mali malin, fusha fushën, zemra zemrën zgjon. Si lumenj nëpër rrug' brigjet, jeta rreh tanë, zërin tënd, hapin tim i rrëmben në gji.	Brezat varg ëndërruan një zgjim ja si ky, me diellin në zemër, me drit' në sy. Mes agimesh të zjarrra hedh shtat brezi im, si grurin sot mbjell ditët që vijn'.	- Refreni - Gëzimi i jetës përflaket si vezullim në çdo skaj, ne jemi fladi i ditët që, jemi agimi i saj. - II - Mir'mëngjes, mir'mëngjes zëri zërit i uron	dit' e re, jet' e re vrull të ri kërkon. - Refreni - Në çdo hap çel një këng' këngë dhe një dashuri drejt stacionesh, drejt uzinash ecim un' e ti.
--	--	--	--

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Njerëzit e agimeve”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- ⌚ dëgjimi i vijës melodike të këngës në QR code;
- ⌚ procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- ⌚ demonstrimi i këngës nga mësime dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- ⌚ këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga nxënësit;
- ⌚ mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale;
- ⌚ mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- ⌚ interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- ⌚ këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- ⌚ përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave.
- ⌚ përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempa përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Reflektimi (10 minuta)

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në:

N2: diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re;

N2: këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;

N3: interpretimin e këngës me emocion;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup, korrekt në ritëm dhe në intonacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për dëgjimin (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Udhëzohen nxënësit për krijimin e një eseje duke shpjeguar përjetime të ndryshme.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema “Zhanret muzikore –rok, pop, hard rok”		Rezultati i të nxënit të temës: - dallon zhanrin muzikor të këngëve dhe veprave muzikore që performon dhe dëgjon, identifikon qartë elementet përcaktuese të zhanrit të caktuar muzikor; - shprehet për karakteristikat e veprës muzikore (formën, llojin, zhanrin përmbajtjen) me komentim, me shkrim, forma vizuale, prezantim me teknologji bashkëkohore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNE3. Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor. 3. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror; 4. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 4.1. prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Muzika moderne, rryma dhe përfaqësues”			
Fjalët kyçe: rok, pop, hard rok.			
Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore: - identifikon kuptimin e muzikës rok, pop, hard rok; - identifikon këtë lloj zhanri përmes këngëve, melodive dhe këngëtarëve apo grupeve; - identifikon këngët më të spikatura të kësaj muzike. - përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të prezantuar punën e vet; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Artet, gjuha dhe letërsia Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi muzikën moderne.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes brainstorming (dëgjim ikëngët “Jailhouse Rock” dhe “No more” të kënduar nga Elvis Presli), ku mësuesi nxit nxënësit të flasnin duke bërë krahasimin mes tyre, duke veçuar ndryshimet për sa i përket ritmit dhe melodisë në lidhje me dëgjimin e saj.

Nxënësit diskutojnë në lidhje me të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)

Njohuritë e reja fillojnë me:

shpjegimin mbi kuptimin e muzikës rok, pop, hard rok;

- identifikimin dhe shpjegimin identifikon këtë lloj muzike përmes këngëve, melodive dhe këngëtarëve apo grupeve;
- shpjegimin konkret përmes dëgjimit të disa këngëve nga këngëtarë të ndryshëm;
- nxitjen e nxënësve për të bërë krahasimin midis këngëve dhe llojeve të muzikës së studiuar;
- nxitjen dhe drejtimin për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi muzikën e kësaj periudhe nga interneti, dhe prezantimin e tyre në klasë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi zhanret muzikore.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin e zhanreve të ndryshme të muzikës së rokut, popit, hard rokut;

N3: shpjegimin duke identifikuar këtë lloj muzike përmes këngëve, melodive dhe këngëtarëve apo grupeve;

N4: realizimin e informacioneve shtesë mbi muzikën rok, pop, hard rok në grup duke përdorur medie të ndryshme (DVD, CD, magnetofon) për të prezantuar punën e vet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë në zhanrin e tyre të parapëlqyer dhe krijojnë një punim të vetin.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë		Rezultati i të nxënit të temës: - këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë, muzikë e popullarizuar etj.) sipas tekstit notal dhe imitimit; - vlerëson këndimin dhe interpretimin e vet dhe të tjerëve duke përdorur saktë shprehjet dhe elementet e performimit cilësor muzikor.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.

II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

V.2. Dëshmim i vetëbesimit.

VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

RNF.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kënga “The final countdown”

Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.

Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore:

- komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Teksti nxënësit: Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari bisedë me nxënësit, duke u kërkuar atyre të flasin lidhur me fuqinë e transmetimit që ka teksti dhe melodia e kësaj kënge.

Diskutohen rreth kësaj teme.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës "The final countdown", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënësit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- ⌚ dëgjimi i vijës melodike të këngës në QR code;
- ⌚ procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga)
- ⌚ demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- ⌚ këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga nxënësit;
- ⌚ mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale;
- ⌚ mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- ⌚ interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- ⌚ këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- ⌚ përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave.
- ⌚ përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Reflektimi (10 minuta)

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në:

N2: diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re;

N2: këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;

N3: interpretimin e këngës me emocion;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup, korrekt në ritëm dhe në intonacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për dëgjimin (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Udhëzohen nxënësit për krijimin e një eseje duke shpjeguar përjetime të ndryshme.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

- I -

We're leaving together,
But still it's farewell.
And maybe we'll come back
To earth, who can tell?
I guess there is no one to blame
We're leaving ground (leaving ground)
Will things ever be the same again?

- Refreni -

It's the final countdown.
The final countdown
Oh!
We're heading for Venus (Venus)
And still we stand tall
'Cause maybe they've seen us (seen us)
And welcome us all, yeah.
With so many light years to go
And things to be found (to be found)
I'm sure that we'll all miss her so.

- Refreni -

It's the final countdown...
The final countdown [2x]
The final countdown
Oh!

- Refreni -

It's the final countdown
The final countdown [2x]
It's the final countdown
We're leaving together
The final countdown
We'll all miss her so.
It's the final countdown.

- Refreni -

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë		Rezultati i të nxënit të temës: - këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë, muzikë e popullarizuar etj.) sipas tekstit notal dhe imitimit; - vlerëson këndimin dhe interpretimin e vet dhe të tjerëve duke përdorur saktë shprehjet dhe elementet e përforcimit cilësor muzikor.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kënga “Këngë moj”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore: - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari konkrete me nxënësit, duke u kërkuar atyre të ngjyrosin të gjitha figurat letrare që ka përdorur poeti. Diskutohet rreth tyre.			

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Këngë moj”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të nxënës.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- ⌚ dëgjimi i vijës melodike të këngës në QR code;
- ⌚ procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- ⌚ demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- ⌚ këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga nxënësit;
- ⌚ mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale;
- ⌚ mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- ⌚ interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- ⌚ këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- ⌚ përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi me të mëdha, këndimi i të gjitha strofave.
- ⌚ përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Reflektimi (10 minuta)

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

- I -

Këngë moj ti merre dhenë
Kush ta di moj ty folenë
Mos më rri ti e ngujuar
Shëroi shpirtrat e helmuar
Hej, hej, hej, hej, hej, hej!

- Refreni -

Këngë moj buçit në male
Dhe barinj! le të hedhin valle
Edhe qingjat le t'blegrojnë
Kur bilbilat të këndojn' o hej!

- II -

Këngë moj ti thuaja lartë
Mallëngjim djalli ta marrtë
Këngë moj na mbush me
gëzime
Se n' ty shpirt gjen ngushëllime
Hej, hej, hej, hej, hej, hej!

- Refreni -

Këngë moj buçit në male
Dhe barinj! le të hedhin valle
Edhe qingjat le t'blegrojnë
Kur bilbilat të këndojn' o hej!

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në:

N2: diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re;

N2: këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;

N3: interpretimin e këngës me emocion;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup, korrekt në ritëm dhe në intonacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për dëgjimin (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Udhëzohen nxënësit për krijimin e një eseje duke shpjeguar përjetime të ndryshme.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Kreativitet muzikor		Rezultati i të nxënit të temës: - krijon tërësi të reja muzikore në bazë të rikrijimit, tekstit poetik etj. - shfrytëzon teknologjinë bashkëkohore (dhe atë muzikore) sipas interesimit dhe prirjes për të performuar dhe krijuar shprehje; - shprehet për veprën e dëgjuar muzikore me vizatim, ese, poezi ose forma tjera shprehëse artistike; - shprehet për karakteristikat e veprës muzikore (formën, llojin, zhanrin përmbajtjen) me komentim, me shkrim, forma vizuale, prezantim me teknologji bashkëkohore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive. II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.1. Mësimi për të mësuar/nxënë – vetorganizimi i të nxënit. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë. RNF4. Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike. • Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikat e përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike. • Përjeton, analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike elementet karakteristike dalluese të kryeveprave artistike të trashëgimisë kulturore dhe artistike (muzikore, pamore, dramë, vallëzim) në kontekst kombëtar dhe më të gjerë. Çmon diversitetin kulturor ne rajon dhe më gjerë.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Krijim muzikor			
Fjalët kyçe: krijim, pikturë.			
Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore: - punon krijimin e vet bazuar në njohuritë muzikore, mbi ritmet e mësuara dhe simbolet muzikore; - zhvillon krijimin përmes arteve të tjera; - shpjegon emocionet e përjetuara nga muzika, dhe shprehjen e tyre me një art tjetër; - çmon dhe respekton punën e vet dhe të shokut.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Teksti nxënësit: Art muzikor 9, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Mësimi fillon me një dëgjim nga koncerti “Pranvera” nga “Katër stinët” e Antonio Vivaldit, duke përcjellë emocionet e tua përmes artit figurativ, duke përdorur elementet e artit.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)

Fillohet duke orientuar nxënësit si të kuptojnë karakterin në muzikë dhe ta shprehin atë përmes ngjyrave.

Hapat për të zhvilluar krijimin tënd.

- Dëgjo koncertin “Pranvera” nga “Katër stinët”.
- Përcakto karakterin dhe shpejtësinë e melodisë: allegro, moderato ose adagio.
- Vazhdo të dëgjosh veprën muzikore dhe fillo të skicosh punimin tënd nëpërmjet emocioneve që të jep muzika.
- Pasi të skicosh idenë, fillo ngjyrosjen e punimit me ngjyrat që ke zgjedhur.



Wassily Kandinsky, Improvizim nr. 26 (vaj në kanavacë, ArtsDot)

Plotëso pas dëgjimit dhe krijimit:

- Koncerti: “Pranvera”
- Kompozitori: Antonio Vivaldi
- Shpejtësia në të cilën ekzekutohet pjesa: _____
- Karakteri i pjesës: _____
- Ngjyrat që unë përdora në punimin tim: _____
- Instrumenti që luhet vepra muzikore: _____

Grupi i dytë

Vendoset për dëgjim nga vepra “Fluturimi i brumbullit” e R. Korsakov, duke përcjellë emocionet e tua përmes artit figurativ, duke përdorur elementet e artit.

Reflektimi (10 minuta)

Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin rreth krijimeve që ata kanë bërë në punimet e tyre, duke vlerësuar dhe respektuar punimet e njëri tjetrit.

Plotëso pas dëgjimit dhe krijimit:

- Vepra muzikore: “Fluturimi i brumbullit”
- Kompozitori: Rimski-Korsakov
- Shpejtësia në të cilën ekzekutohet pjesa: _____
- Karakteri i pjesës: _____
- Ngjyrat që unë përdora në punimin tim: _____
- Instrumenti me të cilin luhet vepra muzikore: _____

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve:

N2: përgatitjen e krijimit të vet bazuar në njohuritë muzikore;

N3: zhvillimin dhe prezantimin e krijimit të vet;

N4 shpjegimin e dhënies së mendimeve në lidhje me muzikën dhe krijimit të vet;

N4: Respektimin e punës e vet dhe të shokut.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për çmuarjen e krijimit dhe respektimin e punimit të shokëve. Nxiten të zhvillojnë krijime të tjera duke i pasuruar portofolet e tyre.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngë		Rezultati i të nxënit të temës: - këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë, muzikë e popullarizuar etj.) sipas tekstit notal dhe imitimit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kënga “Mall për mëmëdhenë”			
Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim			
Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, CD,mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi dhe Shoqëria dhe mjedisi Atdheu im /krahina ime.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari bisedë me nxënësit, duke u kërkuar atyre të flasin nëse u ka rastisur t'i marrë malli për qytetin/fshatin e tyre kur kanë qenë larg tij. Diskutohet rreth kësaj teme.			

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Mall për mëmëdhenë”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënës.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- I -

Në breg pul'bardhat çajnë fluturim
si kënga jon' plot mall,
këndojm' nga larg
me dashuri, moj Arbëri.
Të parët tanë me breng' të lan'
sa kohë më nuk të pan',
por sot si lule më je ti,
moj Shqipëri.

- Refreni -

Valët e detit shkumbojn' plot dallg'

bashkë me shokët në breg kemi dal',
sa kemi mall s'ka deti val',
o moj e bukur Arbëri.
Shikojm' nga larg
mendojm' për ty,
o moj e bukur Shqipëri.
Këtej ne degët, ti rrënjë matan,
mes detit në stuhi,
shkuan kaq mote e degët s'u than',
moj Arbëri.
Kjo kënga jonë për ty përher',
na djeg si zjarr në gji

tek zjarri yt ne jemi përjet',
moj Shqipëri.

- Refreni -

Valët e detit shkumbojn' plot dallg'
bashkë me shokët në breg kemi dal',
sa kemi mall s'ka deti val',
o moj e bukur Arbëri.
Shikojm' nga larg mendojm' për ty
o moj e bukur Shqipëri,
shikojm' nga larg mendojmë për ty,
o moj e bukur Shqipëri!

- ⌚ dëgjimi i vijës melodike të këngës përmes QR code-it;
- ⌚ procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- ⌚ demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- ⌚ këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga nxënësit;
- ⌚ mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale;
- ⌚ mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- ⌚ interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- ⌚ këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- ⌚ përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave.
- ⌚ përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Reflektimi (10 minuta)

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në:

N2: diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re;

N2: këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;

N3: interpretimin e këngës me emocion;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup, korrekt në ritëm dhe në intonacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për dëgjimin (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Udhëzohen nxënësit për krijimin e një eseje duke shpjeguar përjetime të ndryshme.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (Nëntë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria Tema “ Krijues dhe performues”		Rezultati i të nxënit të temës: - Njeh krijuesit dhe performuesit e veprave muzikore artistike që dëgjon, nga literatura botërore e periudhave dhe stileve të ndryshme dhe nga krijimtaria kombëtare. - Njeh, analizon dhe krahason veprat muzikore të dëgjuara, sipas karakteristikave themelore: formës, tonalitetit, stilit, periudhës, gjinisë/ llojit, formacionit interpretues dhe krijuesve të tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.1. njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror; 3.2. demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasikja, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile). 3.3. prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: "Interpretues shqiptarë"			
Fjalët kyçe: interpretim, performim, përkryerje artistike			
Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore: - identifikon interpretues të muzikës shqiptare /kosovare përmes dëgjimit; - shpjegon veprën muzikore që interpretuesit luajnë në shfaqje të ndryshme muzikore; - shfaq parapëlqimin e vet, duke argumentuar shembuj të ndryshëm muzikore; - sjell informacione për interpretuesit më të njohur të muzikës shqiptare kudo; - respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënës, Art muzikor 9, QR code, CD, mjete të tjera për të punuar.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet

Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko-kulturore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)**

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete (brainstorming), përmes një foto të vendosur në projektor nxit diskutimin lidhur me interpretues të ndryshëm. Ata/ato flasin rreth njohurive që kanë për këta artistë.

Ndërtimi i njohurive të reja -(30 minuta)


Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, me një teknikë

Harta e të pyeturit ku mësimdhënësi

paraqet emrat e interpretuesve të suksesshëm shqiptarë, dhe u kërkon nxënësve/eve të flasin rreth veprimtarisë së tyre të sjella edhe përmes tekstit të nxënësit.

Vazhdohet me dëgjimin e veprave muzikore:

- fragment nga opera “Madamë Batërflaj” – Ermonela Jaho.
- fragment nga opera “Traviata” – Josif Gjipali.
- fragment nga opera “Traviata” – Elbenita Kajtazi.



Ata flasin rreth përjetimit emocional dhe dëgjimor ndaj këtyre veprave, duke sjellë edhe fakte mbi interpretuesit shqiptarë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi veprimtarinë e interpretuesve shqiptarë nëpërmjet teknikës

Diagrama e Venit ku vendosen dy interpretues të njohur shqiptarë, duke diskutuar të veçantat dhe të përbashkëtat e tyre.

Përgjigjet mund të jenë të ndryshme:

- Këndimi
- Kombësia
- Virtuoziteti
- Suksesi

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: dëgjimin e veprave muzikore, duke listuar përfaqësuesit shqiptarë interpretues që kanë dhënë kontributin e tyre;

N3: shpjegimin e veprave që dëgjon duke thënë pse i pëlqen këndimi nga një interpretues i caktuar;

N4: grumbullimin dhe prurjen në klasë me CD/DVD të veprave muzikore të interpretuara nga shqiptarë/kosovarë;

N4: bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë interpretime nga repertori i interpretuesve të ndryshëm shqiptarë dhe kosovarë me përdorimin e mediave (DVD, CD, magnetofon), grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet;

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (Nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Kreativitet muzikor		Rezultati i të nxënit të temës: - Shfytëzon teknologjinë bashkëkohore (dhe atë muzikore) sipas interesimit dhe prirjes për të performuar dhekrijuar shprehje origjinale muzikore - Shprehet për karakteristikat e veprës muzikore (formën, llojin, zhanrin përmbajtjen) me komentim, me shkrim, forma vizuale, prezentim me teknologji bashkekohore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 3 1.2. Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri para audiencave të ndryshme, duke kombinuar format dhe mjetet shprehëse të arteve edhe me ndihmën e teknologjisë (prezantime multimediale, instalacione etj.).			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Mjetet teknike per regjistrim e dëgjim muzikor			
Fjalët kyçe: rregullat e luajtjes në instrument, ritëm,			
Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore: • Përshkruan mjetet e inçizimit dhe dëgjimit që përdor; • shpjegon mjetet e inçizimit dhe dëgjimit si; magnetofon, radio, studio regjistrimi etj; • argumenton rëndësinë e mjeteve të regjistrimit dhe dëgjimit në jetën e përditshme; • respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; • ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit: Art muzikor 9, instrumenti muzikor.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit, duke iu kërkuar atyre të sjellin përvojë e tyre me mjete të ndryshme regjistrimi që ai/ajo ka në shtëpi.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)

Vazhdohet mësimi me një teknikë pyetjesh, ku zhvillohen pyetje nga më e lehta deri tek më e vështira duke filluar me objektet e jetës së përditshme:

- Telefoni celular
- Televizori
- Radio
- Mp 3
- Kasetofoni
- Magnetofoni
- Studio regjistrimi

**Reflektimi (10 minuta)**

Më pas vazhdohet me tekniken e klasterit lidhur me njohuritë mbi pajisjet.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e afëtsive të nxënësve:

N2: Përshkrimin e mjeteve të inçizimit dhe dëgjimit që përdor;

N3: Shpjegimin e mjeteve të inçizimit dhe dëgjimit si; magnetofon, radio, studio regjistrimi etj;

N4: Argumentimin e rëndësisë së mjeteve të regjistrimit dhe dëgjimit në jetën e përditshme;

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për zhvillimin e një detyre duke shpjeguar një pajisje për dëgjim apo inçizim në shtëpi.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX (Nëntë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Interpretim në instrumente		Rezultati i të nxënit të temës: - Shoqëron këngët dhe luan pjesë instrumentale sipas imitimit ose me tekst notal, në zhanre të ndryshme, individualisht dhe në grupe.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

- I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.
 II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
 II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
 III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
 IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
 V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
 VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

RNF.1. Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Luajmë në kitarë

Fjalët kyçe: kitarë, ritëm, intonacion

Rezultati/ete të nxënit për orë mësimore:

- Njeh pozicionet dhe rregullat e luajtjes në instrumentin e kitarës;
- luan nota ose akorde të ndryshme në instrumentin e kitarës;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:


Teksti nxënësit: Art muzikor 9, instrumenti muzikor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit, duke iu kërkuar atyre të thonë çfarë dinë rreth instrumentit të kitarës.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)

Demonstrohet nga mësindhënësi pastaj nga nxënësit instrumenti i kitarës duke u shpjeguar rregullat e luajtjes me kitarën.



Mësimdhënësi kujdeset që fillimisht të shikohen mirë vendosja e gishtave sipas notave.

Shpjegime të mëtjshme lidhur me instrumentin e kitarës duke u ushtruar.

Më pas vazhdohet ekzekutimi me ushtrimet e tjera që ka teksti ose ushtrime të sjella nga mësimdhënësi.

	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4
1 Mi	Fa	Fa# Solb	Sol	Sol La b	La	La# Sib	Si	Do	Do# Reb	Re	Re# Mib	Mi ecc.
2 Si	Do b	Do# Reb	Re	Re Mib	Mi	Fa	Fa# Solb	Sol	Sol# Lab	La	La# Sib	Si ecc.
3 Sol	Sol# Lab	La	La# Sib	Si	Do	Do# Reb	Re	Re# Mib	Mi	Fa	Fa# Solb	Sol ecc.
4 Re	Re# Mib	Mi	Fa	Fa# Solb	Sol	Sol# Lab	La	La# Sib	Si	Do	Do# Reb	Re ecc.
5 La	La# Sib	Si	Do	Do# Reb	Re	Re# Mib	Mi	Fa	Fa# Solb	Sol	Sol# Lab	La ecc.
6 Mi	Fa	Fa# Solb	Sol	Sol# Lab	La	La# Sib	Si	Do	Do# Reb	Re	Re# Mib	Mi ecc.

Reflektimi (10 minuta)

Më pas vazhdohet me ushtrimet me kitarën sipas njohurive që ka teksti.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e afëtsive të nxënësve:

N2: demonstrimin me korrektësi të respektimit të rregullave të luajtjes me instrumentin e kitarës.

N3: luajtjen me nota ose akorde të ndryshme në instrumentin e kitarës.

N4: bashkëpunimin gjatë mësimit të ushtrimeve me kitarës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për përsëritjen e njohurive të marra mbi instrumentin e kitarës në shtëpi.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Art muzikor	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII (tetë)
Konceptet: Çmuarja dhe vlerësimi estetik dhe artistik TEMA “Vepra dhe ngjarje muzikore”		Rezultati i të nxënit të temës: - Komenton ngjarje të ndryshme artistike kombëtare, dhe botërore. - Marrin pjesë në aktivitet të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës dhe vlerësojnë ato.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.3. Identifikon dhe emërtin vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Profesionet muzikore”			
Fjalët kyçe: institucion muzikor, ngjarje muzikore			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - identifikon profesionet muzikore nëpërmjet pamjes apo përjetimit konkret; - shpjegon profesionet muzikore duke veçuar karakteristikat e tyre; - grumbullon material për profesionet muzikore; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënës, Art muzikor 9, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes brainstorming (foto/postera/filmime), ku mësuesi nxit nxënësit të flasin në lidhje me profesionet të cilët kanë zhvilluar muzikën shqiptare sipas profesionit që ata kanë zgjedhur.

Nxënësit diskutojnë në lidhje me të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)

Më pas zhvillohet një kuiz ku nxënësit plotësojnë të gjitha aftësitë që duhet të zotërojnë një profesion i caktuar.

- Kompozitori
- Dirigjenti
- Instrumentisti
- Këngëtari
- Muzikologu
- Etnomuzikologu
- Mësimdhënësi

Ata zgjerojnë më shumë diskutimin lidhur me profesionet muzikore.

Nxënësit nxiten për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi profesionet muzikore që ju kanë lënë mbresa nga interneti, dhe sjellin prezantimin e tyre në klasë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi profesionet muzikore përmes një klasteri apo diagrame veni.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin e profesioneve muzikore nëpërmjet pamjes apo përjetimit konkret;

N3: shpjegimin e profesioneve muzikore duke veçuar karakteristikat e tyre;

N4: grumbullimin e materialeve për profesionet muzikore;

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të zhvillojnë punimin e tyre për një nga profesionet muzikore.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

REFERENCA

- Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët të Kosovës, Prishtinë, gusht 2016
- Kurrikulat lëndore/Planprograme, *Art muzikor 9*, Prishtinë, 2018
- Korniza Kurrikulare e Kosovës, Prishtinë, gusht 2016

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:78(072)(075.2)

Hala, Majlinda

Art muzikor 9 : libër për mësuesin/en : për klasën e 9-të të
arsimit 9-vjeçar / Majlinda Hala. - Prishtinë : Pegi, 2024. - 117
f. : ilustr. ; 28 cm

ISBN 978-9951-843-36-2